

LEXMARK
LEGAL

Nese ju duhet një avokat
mos hezitoni te na kontaktoni



Adresa: Ashley House 235-239 High Road
Wood Green, London, N22 8HF
Tel:0208 090 2488 info@lexmarklegal.com



Tel:07435119343
Tel:07494181220
Tel:07379691924



The Albanian

VITI I 20 I BOTIMIT 25 NENTOR 2024


Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

**RAMA NË LONDËR
SHQIPTARËT E PËRGJAKUR**



PETRIT KUÇANA

**PËRSE RAMA
NUK U TAKUA
ME SHQIPTARËT
E BRITANISË?**



ALFRED LELA

**PSE RAMA
SHKOI
'I ARMATOSUR'
NË LONDËR?**

**FUQIA E FJALËS
SË FISHTËS
NË KONGRESIN
E MANASTIRIT**

DAUT DAUTI

**RAMA – MARANGOZ I ZOTI I
SKENAVE KOMIKE,
AKTOR I DOBËT NË SKENËN
NDËRKOMBËTARE**

MAL BERISHA

**TË KAPUR
NË FLAGRANCË:
VRASËSIT E KOMBIT!**



SONILA MEÇO

**ÇFARË I DUHET SHQIPËRISË
SOT! NJË SHËNIM
PËR PRINDËRIT TANË DHE
BREZAT E ARDHSHËM**

DITMIR BUSHATI

**KARAFILAT
E CELESTE CAEIROS**

VETON SURROI



**POROSISNI BANNERIN
PËR BIZNESIN TUAJ**

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dotech
website




The Albanian newspaper in London



www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Një barrelë që bart një shqiptar në mes forcash policore britanike dhe shqiptarë të tjerë të përgjakur, mbetet tabloja e trishtë e ‘Ramës në Londër’.

Në kufinj të të pabesueshmes përshtafën ato skema të tmerrshme në zemër të Londrës, ku disa protestues paqësor, ‘guxuan’ të mbanin një pankartë në duar, ndërkohë që kryeministri po lexonte fjalimin e tij.

I shtyrë prej shumë kohësh vizita, takimi, turi (e gjithfarë lloj emërtimi që mund t’i ngjitet) i kryeministrit në Londër u përgatit prej muajsh e muajsh. Thuhet se ishin të rrallë kryetarët e bashkive që ‘guxuan të mos vinin’ në Londër për të dhënë një dorë plotpërbushjes së etjes së kryeministrit për duartrokitjet e diasporës.

Pra katër muaj parapërgatitje për një fjalim 40 minutësh?

Duhet theksuar se në asnjë moment nuk është prezantuar si kryetari i PS-së por vetëm si kryeministri, që na bashkokërka shqiptarët e Britanisë nën tam-tam-et folklorike, por që duket se Londra mbeti kafshata e pakapërdishme në të gjithë propagandën e tij me paradoksin e madh ‘Krenar për Shqipërinë’. Të paktën në Londër nuk ngjiti kjo ‘gjetje’ që kthen në paradoksin e gjithanshëm.

Shqiptarë që vazhdojnë të vijnë me gomone në ishullin Britanik duke rrezikuar jetën e duke ikur nga sytë këmbët nga ajo “Shqipëria krenare” e kryeministrit.

PËRSE NUK U TAKUA RAMA ME SHQIPTARËT E BRITANISË?

Mbase duhet që së pari të theksohet se ‘turi’ i kryeministrit në Londër nuk është takim. Nuk ka patur takime të kryeministrit me shqiptarët e britanisë, JO! Kryeministri erdhi me gjithë shpurën e tij, mbajti një fjalim dhe iku.


Çfarë do të ndodhte nëse kryeministri do të takohej me përfaqësuesit e shqiptarëve që kanë ikur nga ajo ‘Shqipëria krenare’ dhe që sot janë në të zezën dhe që besohet se janë dhjetëra-mijëra dhe se kushedi sa forcë iu është dhuruar që të besojnë se kryeministri mund të bëjë një gjë për ta, qoftë edhe si detyrim kushtetues (neni 8)?

A mund të ishin ata indikatorit se çfarë duhet të ndryshojë qeveria në mënyrë që Shqipëria të mos vazhdojë të zbrazet?

Mbase kryeministri do të mësonte se janë me mijëra e mijëra shqiptarë të deportuar nga Britania sipas marrëveshjes së tij me homologun britanik dhe se shteti që ai drejton nuk ka adresuar asnjë zgjidhje për ta.

Mbase do të mësonte se paktën e maleve apo çdo lloj iniciative tjetër ta fillonte me ta, pikërisht me të deportuarit, duke parandaluar një tmerr tjetër që pret mjerisht shumë prej tyre, rënien e kthetrat e krimin të organizuar, të atyre që mjerisht vazhdojnë të mbeten shqetësimit për shoqërinë shqiptare dhe jo vetëm. Mbase do të ishte koha që Rama të vinte si llogaridhënës dhe jo si fjalimmbajtës.

Çfarë do të ndodhte nëse kryeministri do të takohej me përfaqësuesit e shoqata shqiptare të këtushme, me mësuesit e shkollave shqipe që prej dekadash tashmë po kultivojnë tek të rinjtë gjuhën, traditat dhe vlerat më të mira shqiptare?



Përse Rama zgjodhi të mos takohet me akademikët shqiptarë në Britani, me ata që mbetet shkëlqimi i krenarisë sonë, PHD-të, doktorët, shkencëtarët dhe pedagogët shqiptarë që lektorojnë në universitetet britanike, apo profesionistët nga fusha të ndryshme të jetës, që me historitë e tyre mbase do të bënin krenar edhe Ramën që kushedi do të skuqej që prej 12 vitesh nuk ka denjuar që të takohet me ta?

Besohet se në Britani janë mbi 5 000 biznese shqiptare. Çfarë do të ndodhte nëse Rama do të takohej me përfaqësues të tyre?

A do të ishte më e lehtë t’ua prezantonte ‘paketën e maleve’ si dhe t’ua shpjegonte se përse nuk ka ‘paketë detesh’ dhe përse deri më tani asnjë investitor strategjik na rezulton të jetë nga Diaspora.

Kushedi sa e vështirë do të kishte qenë kapërdirja e emrave të përzgjedhur si investitorë strategjikë, nga ata që janë tashmë

të burgosur si trafikantë droge e deri tek bashkëshortë ministrash.

Me patjetër Rama do të ndryshonte rrënjësisht konceptin e të bërit shtet dhe mbase mbase do të bindej se për të fituar votën e diasporës së pari duhet të bëjë publike shpenzimet e këtyre ‘fjalimeve’ dhe se nuk është e domosdoshme më forma sesa përmbajtja.

Vetëm kështu do të mbrohej nga çdo ironi therëse se Rama në Londër u takua me Taulant Ballën apo me Blendi Klosin e Pandeli Majkon, ish-ministrin e Diasporës.

Kaq shumë vëmendje kishte për diasporën sa edhe një ministrë pa portofol e shkarkoi fare.

E nëse do të vazhdojë këto takime edhe më shqiptarët e sheteteve të tjera do të kuptonte se bërja e një fjalimi nuk mjafton për të bindur sidomos shqiptarët e diasporës se ti nuk dije asgjë për frutangerësit.

Së fundmi sa kushtoi fjalimi i

Ramës në Londër?

A duhet të përshihen në përllogaritje ata kryebashkiakët me stafert e tyre, drejtorët e drejtorive etj etj? Përllogaritjet minimale janë nga £1000 secili? A duhet të kishte pak transparencë për këto fjalime? Sa kushtoi fjalimi i Athinës, Selanikut, Milanos apo New Yorkut?

Përse ka frikë Rama të bëjë transparencën e tyre, si kryeministri i një prej vendeve më të varfëra të Evropës?

Po sikur kryeministri t’i regjistronte këto fjalime specifike për gjithësecilin komunitet shqiptar, a do të kishte media që nuk do t’i transmetonte?

Apo etja e kryeministrit për duartrokitje nuk do të shuhej? Mos qoftë ajo që mendohet; alibia për votën në masë të diasporës.

E si mund të spjegohet ndryshe i gjithë ai strapacim i të gjithë shpurës së Ramës nëpër Londër prej katër muajsh për 40 minuta fjalim?

**L E X M A R K
L E G A L**

Ashley House 235-239 High Road
Wood Green, London, N22 8HF



**07435119343
07494181220
07379691924**

**NESE JU DUHET NJË
AVOKAT MOS HEZITONI
TE NA KONTAKTONI**

Individual & Family Visas

- Asylum and Human Rights
- Family and Spouse visa
- European visas
- Student or tier 4 visa
- Visitor visa
- Indefinite leave to remain
- British citizenship

Appeals & Administrator Review

- Immigration Appeals and Review
- Immigration Detention,
- Bail and Removal



Për më shumë informacione në lidhje me procedurat ligjore, ju lutem kontaktoni ekspertët tanë ligjorë të cilët do t'ju ofrojnë çdo konsultë ligjore të domosdoshme

Tel:0208 090 2488 info@lexmarklegal.com

 Discover The Latest Trends in Technology

Dotech
website 

“ **AKOMA NUK KENI
NJË WEBSITE PËR
BIZNESIN TUAJ?** ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Dotech
website 

Për çdo konsultim mund të na kontaktoni
ose mund të vini në zyrat tona

- BUSINESS CARDS
- LOGO
- BANNERS
- POSTERS
- VIDEO MARKETING



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

MY **UK**
Law

AVOKATI JUAJ
SHQIPTAR
I LICENCUAR NGA SRA

MY **UK**
Visas

Ne jemi të specializuar në:
Çështje emigracioni
Çështje familjare dhe divorci
Pronësi
Neglizhencë
Gjoha dhe dënime rrugore



Arta Heath

Avokate dhe Partnere Menaxhuese

Na kontaktoni nga e Hëna në të Premte, nga ora 9:00 - 17:30



Huddersfield

Besmir Mujo

+44 (0) 7861 391147



Sheffield

Klodiana Gjonaj

+44 (0) 7454 819683



London

Daniel Buna

+44 (0) 7832 599757



Tirana

Dorotea Celaj

+355 69 659 8957

Për linjën jashtë orarit, kontaktoni +44 (0) 7931 327665 çdo ditë jave pas orës 17:30 deri në 20:30 dhe ditën e shtunë nga ora 09:00 deri në 12:00.



reviewsolicitors
TRUSTED LAW FIRM



"EXCELLENT"

4.8 / 5 STARS | 152 REVIEWS



Ranked
TOP 10%

2024



Solicitors
Regulation
Authority

DAUT DAUTI

Sot, kur u festua përvjetori i Alfabetit, dëgjuam lloj-lloj komentesh. Shumica e komenteve flasin për rëndësinë që pati Kongresi për gjuhën shqipe. Në fakt rëndësia e Kongresit për gjuhën ka qenë më e vogla në krahasim me tjerat.

Kongresi i Manastirit është momenti kur kombi shqiptar po bashkohej dhe po e merrte formën përfundimtare. Rëndësia politike është më e madhe se ajo gjuhësore apo kulturore.

Në shënim të këtij përvjetori duhet t'i kujtojmë disa momente apo detaje të rëndësishme të Kongresit kur të gjithë intelektualët shqiptarë sikur edhe populli e kishin gjithnjë e më të qartë se Perandoria Otomane do të përfundonte dhe se tokat shqiptare po rrezikoheshin nga fqinjët. Më poshtë e keni një përkthim të shkurtër i cili e spjegon situatën në sallë gjatë dhe pas përfundimit të fjalimit të Gjergj Fishtës:

'Fjalët e At Gjergj Fishtës patën ndikim të fuqishëm dhe lanë përshtypje të thellë në shumë njerëz. Pasi që përmendi shkurtimisht një punë të madhe që kishte bërë klubi 'Bashkimi' i Shkodrës, të cilin ai e përfaqësonte, fjalimin e përfundoi me këto fjalë:

'Nuk kam ardhë këtu ta mbrojtë ndonjë alfabet të veçantë por kam ardhë që të bashkohem me ju dhe ta pranoj alfabetin të cilin do ta zgjedhë Kongresi e që do të jetë më i dobishmi për ta zgjuar popullin'.

Ai gjithashtu tha: 'Armiqtë që e rrethojnë Shqipërinë janë të shumtë dhe të gjithë provojnë të na i marrin tokat por nëse ne nuk mundemi ta mbrojmë atdheun tonë me fuqinë tonë morale, do

FUQIA E FJALËS SË FISHTËS NË KONGRESIN E MANASTIRIT



mund ti përshkruaj lehtë këshillat e vlefshme që na i dha Fishta. Ishin aq të rëndësishme sa që të krishterët dhe myslimanët nuk mundën t'i ndalnin lotët. Kur At Gjergj Fishta e përfundoi fjalimin dhe kur po zbriste nga podiumi, hoxhë Hafiz Ibrahim efendiu, i cili e përfaqësonte klubin e shqiptarëve të Shkupit, i doli shpejt përpara, e përqafoi dhe e puthi duke i rjedhur lotët nëpër faqe. Kjo skenë që ndodhi në prezencë të diku rreth 300 deri në 400 njerëz, nga të cilët dy të tretat ishin myslimanë, la përshtypje jashtëzakonisht të thellë te të gjithë ne.'

Marrë nga libri: National Education During Albanian Renaissance, faqe 231-2, të autorit Hysni Myzyri

ta mbrojmë me armë dhe nuk do t'i lejojmë armiqtë e Shqipërisë që ta marrin asnjë pëllëmbë të territorit tonë.'

Duke ju referuar këtyre fjalëve, Gjergj Qiriaz, njëri nga pjesëmarrësit e Kongresit, shkroi: 'Nuk



NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

**POROSISNI
BANNERIN PER
BIZNESIN TUAJ**

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946

Emigracion dhe Prona

- Aplikacione per visa bashkshortore, si te fejuar dhe visa turistike
- Heqja e Nenshtetsis Britanike
- Ankesat gjyqsore, Ndalimi pa letra ne Kampe Emigracioni dhe Urdhra Deportimi
- Aplikime per Viza Studenti dhe Viza Pune
- Aplikime per Viza ne Baza te Drejtave te Njeriut nga brenda Britanis
- Ceshtje Azii dhe Skllaveri Moderne

- Shitje dhe Blerje te Pronave
- Rihipoteka dhe Financimi i Pronave
- Dhenie me Qira te pronave Komercale
- Zgjatje dhe Rinovime te Kontratave te Pronave Komercale

Sigurojeni te ardhmen tuaj sot me keshillen e duhur profesionale ligjore!



Po Kerkoni Per Ndhime Juridike Nga Ekspert Legal?

Per me shume informacion:

Kontaktoni Partner dhe Avokate:

Oliverta Mediu

Phone: 020 7063 9040

Mobile: 079 4603 5736

Email: o.medi@wslegal.co.uk

Address: 2nd Floor 2-5 Minories,
EC3N 1BJ

ALFRED LELA

Kundërshtarët e gjetën Edi Ramën edhe në Londër. Edhe pse Rama e konsideroi ngjarjen e 24 nëntorit si 'atentat politik' ndaj Shqipërisë, siç bën zakonisht, ai e di se protesta në kryeqytetin anglez është diçka tjetër.

Ai e di këtë, qoftë edhe për faktin se kishte me vete karrocerinë me mbi 200 vetë, aq sa nxë një avion i Ryan Air, të cilin kabineti i tij kishte prenotuar për udhëtimin e kthimit në Tiranë- dhe që u nis me 1.5 orë vonesë për shkak të Ramës dhe shpurës.

Ai e di këtë sepse ndihmësve të tij u janë dashur disa muaj për të pajisur me viza britanike të gjithë shpurën, dhe kjo ka qenë një ndër arsytet se pse tubimi i Londrës është shtyrë disa herë.

Ai e di këtë sepse kishte marrë me vete kryebashkiakët e të gjitha qyteteve veriore që ka PS, duke e shpërfillur faktin se është ai vetë, dhe po ata krerë lokalë, që i kanë detyruar një pjesë të mirë të largohen.

Ai e di mirë këtë, sepse ishte rrethuar nga të fortët e këtyre zonave të cilët, në një mënyrë a tjetër, kanë përfutur nga pushteti i këtyre bashkiakëve dhe i tiji në kontrata publike apo forma të tjera.

Ai e di shumë mirë këtë, sepse 'të ftuarit' në tubimin e tij ishin njerëz që duhet të prenotonin bileta si të ishte një aktivitet sportiv apo artistik. E gjithë kjo bëhet me qëllimin që të kontrolloheshin pjesëmarrësit për të shmanjur pikërisht kundërshtarët.

PSE RAMA SHKOI 'I ARMATOSUR' NË LONDËR



Ai e di mirë këtë, sepse një pjesë e 'biletëmarësve' dëshmojnë se janë paguar deri në 350 paund cash për të marrë pjesë në tubim.

Ai e di mirë këtë, sepse kur protestuesit shpalosën pankartën dhe lëshuan thirrje kundër tij, vetëm një grup i vogël (truprojat e tij dhe të Taulantit dhe disa të fortë të marrë me vete, u angazhuan për të goditur bashkatdhetarët).


Ai e di mirë se nuk ishte Sali Berisha organizatori i protestës, jo se nuk mundej, por se e di se nuk duhet organizim dhe porosi për t'i dalë kundër Ramës, sidomos në diasporën britanike, që është mishërim i emigracionit të dekadës së fundit, dhe përndjekjes që pushteti u ka bërë demokratëve apo qytetarëve të përfshirë me Rilindjen.

Si përherë, Sali Berishën e përdoror mburojë për të gjitha dështimet e veta, nga qeverisja e keqe e deri te mitingu në Londër, që as e nisi as e bitisi siç duhet, por e lau me turpin e vet dhe gjakun e bashkatdhetarëve që, nga atdheu i përzë dhe në vendin e adoptuar i acarun dhe provokon.

Në radhët e cirkut të Edi Ramës askush nuk është dëmtuar, dhe ai mund të ndihet fitimtar, por fakti është se është bërë një lider qesharak, që i duhet të marrë truproja, të fortë dhe policinë vendase, për t'u mbrojtur në dhe të huaj nga qytetarët e vet.

Nëse si zemërim me këtë ai përdor dhunën duke goditur Ilir Meshin e disa guximtarë të tjerë që iu futën mu në shpellën e frikës, aq më keq për të. Dhuna gjithmonë është instrumenti i fundit i bindjes politike, mjeti që dëshmon se gjithçka tjetër ka dështuar. Se nuk të duan dhe as të respektojnë.

Momenti që shpreh fundin politik.



DITMIR BUSHATI

Para një viti ftova në podcastin tim "Public Square", Arjan Gjonca, profesor në Shkollën Ekonomike të Londrës (LSE) dhe ekspert i Kombeve të Bashkuara për çështjet e popullimit dhe të arsimit, me të cilin diskutova për tri rreziqe që i kanosen shoqërisë shqiptare: I) skema e pensioneve; ii) kujdesi shëndetësor; iii) kujdesi shoqëror.

Në të vërtetë, këto janë sfida për çdo shoqëri të përgjegjshme që respekton kontributin e prindërve duke hapur shtigjet e së ardhmes për fëmijët. Pasi, siç thotë me të drejtë Jacques Attali: "Nuk mund të jetojmë në kurriz të brezave të

shkuar dhe atyre të ardhshëm. Të parëve ua hamë kontributin, të dytëve ua rrenojmë trashëgiminë".

Është pozitiv fakti që qeveria e ka kthyer si temë dite skemën e pensioneve, sikundër fushatën komunikuese me sipërmarrjen për deklarimin real të pagave, çka ndihmon ekonominë dhe skemën e pensioneve. Mirëpo, në mënyrë që këto sfida të adresohen dhe të mos mbesin në nivelin e retorikës së ditës, nevojitet ballafaqimi me politikën e zbatuar deri tani, sikundër ndërmarrja e reformave rrënjësore.

Shifrat tregojnë se reforma e skemës së pensioneve të vitit 2014 nuk dha efektin që pritej. Sepse nuk është zgjeruar baza e kontribuesve, shoqëria është plakur, dhe forca aktive e punës vijon të largohet nga vendi. Pensionistët e rinj në skemë në vitin 2023 kanë kontribuar mesatarisht vetëm 27 vite, ndërkohë në vitin 2013 pensionistët e rinj kontribuonin në skemë mesatarisht 31

vite.

Gjithashtu, mbështetja buxhetore e skemës së pensioneve ka rënë. Në vitin 2020 ajo ishte 1.96 % e Produktit të Brendshëm Bruto (PBB), ndërsa në vitin 2023 vetëm 0.63% e PBB-së. Ndaj, mosdeklarimi apo nëndeklarimi i pagave nuk është i vetmi faktor që ka penguar rritjen e pensioneve.

Hendeku financiar mes asaj çka nevojitet dhe thellimit në kontribut nga paguesit e tanishëm nuk mund të mbushet pa zgjerimin e bazës me kontribues të rinj dhe pa mbështetje buxhetore, që vjen si pasojë e përcaktimit si prioritet nga ana e qeverisë. Skema e pensioneve nuk 'shërohet' dot vetëm nëpërmjet të ardhurave të grumbulluara nga kontribuesit e sigurimeve shoqërore. Pasi për shtesën 16 mijë -18 mijë pensionistë në tregun e punës duhet të hyjnë 22 mijë - 23 mijë të punësuar.

Që të ketë kontribues të rinj ne

duhet të pranojmë se skema e pensioneve është vetëm pika fundore e një sistemi që në thelb ka edhe dy elementë të tjerë po aq të rëndësishëm: kujdesin shëndetësor dhe mbrojtjen shoqërore. Këto elementë e kanë gjenezën tek mirëqeverisja dhe modeli ekonomik.

Pa rishikimin e modelit ekonomik të tanishëm, i cili mbështetet në "privatizimin e përfitimeve dhe shoqërizimin e riskut", nuk mund të ketë as skemë pensionesh të qëndrueshme dhe as frenim të largimit të njerëzve nga vendi. Ekonomia shqiptare mbështetet kryesisht në degë si ndërtimi apo turizmi, që janë të përkohshme për mënyrën si duhet të zhvillohet vendi dhe nuk ofrojnë një perspektivë afatgjatë.

Ne na duhet një ekonomi me produktivitet të lartë, që bazohet tek dija, në mënyrë që të krijojë të ardhura më të mëdha dhe një shtresë të mesme të qëndrueshme. Pa arsim cilësor dhe dije është i pamundur produktiviteti i lartë. Njëkohësisht,

na duhet të nxisim degët e reja të zhvillimit që bazohen tek industria e gjelbër, të zhvillojmë burimet energjitike, burimet minerare për zhvillimin e industrisë së rëndë, dhe të orientojmë burimet njerëzore drejt degëve të reja.

Gjithashtu, nevojiten politika aktive që formësojnë ekonominë e jetës. Pra, më shumë demokraci, më shumë shëndet, më shumë arsim, më shumë ushqim të përbalueshëm dhe të shëndetshëm, dhe natyrisht siguri.

Për të dalë nga kjo situatë na duhet të rishpërndajmë burimet dhe të ardhurat, por mbi të gjitha duhet të rishpërndajmë burimet e dijes dhe aftësi përmes arsimit. Pabarazitë e statusit social-ekonomik, e të ardhurave dhe mundësive të jetës, nuk zgjidhen me fushata, lëmshë, e as me gjeljin e detit të fundvitit. Ato duhet të përbëjnë boshtin e veprimit të një qeverisje që orientohet për nga vlerat e të majtës demokratike.



FOR SALE

RESTORANT PËR SHITJE
5 minuta nga Tower Bridge
I hapur prej vitesh
Me klientelë të garantuar



FOR SALE

RESTORANTI NDODHET NË NJË
ZONË SHUMË TË PASUR ANGLEZE

I PAJISUR ME TË GJITHA
LIÇENSAT



FOR SALE

PËR MË SHUMË INFO
KONTAKTONI:
07393453904

ALFRED LELA

Propozimi i z. Rama për të mbyllur Tik Tok-un dhe Snap Chat-in, dy platforma që përdoren edhe nga nxënësit në shkollat e vendit, ngjan, në pamje të parë, si një ide e arsyeshme...po të ishim në Danimarkë.

Por, Kryeministri ka kundër disa fakte, një pjesë e mirë e të cilëve lidhen vetëm me të.

Më i pari është se ai qeveris më shumë nëpërmjet rrjeteve sociale, platformave të massmedias apo komunikimit masiv, sesa drejtpërdrejt në format klasike të politikëbërjes, mbledhje kabineti, konferenca shtypi, takime me njerëzit etj.

Pra, ai është përpunues dhe promovues i një modeli, me lehtësinë e një adoleshenti, të cilin kërkon ta përmbysë me cilësinë e një Kryeministri.

Kjo sipërfaqësi e kryeministrit është vetëm sipërfaqja e hollë, e pacipë, dhe jo thelbi i problemit, i cili, së dyti dhe më së rëndësishmi, është një krizë modeli, njeriu dhe pushteti.

Edi Rama, si një ndër 4 politikanët kryesorë të tranzicionit pas-komunist, ka qenë shtytësi më i fuqishëm i një modeli anti-model në shoqëri.

Ai i ka dhënë përparësi dukjes para thelbit, aktivitetit para punës, suksesit para arritjes, triumfit politik para autoritetit publik. Duke pasë për mbi 20 vjet luksin e një makinerie propagandistike, të shtyrë nga mediat kryesore në vend, ai e ka projektuar këtë model, ku ndërthuren hajgarja poli-

MBYLLJA E TIK TOK NUK ËSHTË MASË, POR MASKË PËR SURRATIN E QEVERISË



tike me brutalitetin shtetëror, si ofertë qeverisëse me thelbin e vetëm: është e ndaluar të ndalosh (frazë e lëvizjes anarkisto-majtiste franceze të vitit '68).

Kujdes: 'liria' e këtij slogani vetëm në sipërfaqe ka parasysh të tjerët, popullin; është dizajnuar për Ramën vetë dhe ata rreth tij. E vetmja liri që populli mund të gëzojë në kohën e Ramës është e shkapërderdhjes: mbillni drogë dhe shisni drogë-pra, liria e pasurimit të shpejtë nëpërmjet anti-modelit. E dyta e lirive, ajo e lëvizjes, më sak e braktisjes së Shqipërisë, e

përkthyer trashë "nëse nuk ia dilni me drogë dhe në administratë, këpusni qafën!

Së treti, Rama, duke lejuar një liri fiktime, krijoi në vend një ndalesë efektive të përgjithshme për kundërshtarit politik, apo çdo formë opozicioni, përkundër mesazhit, imazhit dhe aktivitetit politik të tij dhe qeverisë.

Është dije klasike tashmë se Rama përdori, duke filluar nga 21 janari 2011 e në vijim, pa ndërprerje, elementin jopolitik në rrafshin politik (edhe në zgjedhje), duke kulmuar me

fuqjen e tyre në Kuvendin e Shqipërisë si deputetë 'të popullit'. Më pas ai përforcoi një makinë elektoralo-politike që shtypte çdo rregull e ligjësi në favor të triumfit në zgjedhje. Një ndër viktimat e kësaj qasjeje ishin edhe dy institucione të shtetit: shkollat dhe policia.

Duke krijuar, në sistemin arsimor, modelin e brendshëm të promovimit të mësuesve dhe drejtorëve që kryejnë mirë rolin e operatorit elektoral; dhe më gjerë modelin e të fortit në qytet, Kuvend dhe shoqëri, Rama nuk i lejoi asnjë exit modeleve alternative. Modeli i tij ishte i vetmi, sepse ishte më i miri. Çdo model tjetër u bë anti-model. Duke u sjellë si anti-hero, Edi Rama krijoi heroin dhe shpall anti-heronj gjithë të tjerët. Këtu e ka rrënjën edhe slogani "fajin e ka Saliu", që u shpik si e vetmja alternativë e Ramës dhe Partisë Socialiste.

Në këtë linjë mendimi, sjellje apo modeli, Kryeministri e thjeshtëzoi debatin publik të mbushur me zinë e tri vrasjeve në pesë ditë, më e dhimbshme, ajo e një fëmije shkolle, me frazën 'fajin e ka Tik Tok-u'.

Asnjë përgjegjësi për sigurinë në shkollat, krijimin e modeleve anti-etikë, premtimet e qeverisë, policimin komunitar, e kështu me radhë.

Duke pasë në mendje sinoptikën politike më lart, nuk kemi pse presim

sjellje të ndryshme nga Kryeministri. Ai nuk e ka krijuar modelin, por është vetë modeli, është mishërim i tij. Si në shprehjen e Anjshantit ku nuk mund të presësh rezultate të ndryshme prej së njëjtës metodë, as prej të njëjtit njeri/model nuk mund të presësh sjellje të ndryshuar. Ky është Kryeministri që disa prej jush thoni se keni zgjedhur/votuar, dhe disa të tjerë se është aty prej vjedhesh/ manipulimesh elektorale.

Martin Cani, 14 vjeç, nxënës i "Fan Nolit", fëmijë i prindërve të vet dhe i Shqipërisë, shok i vërsnikëve dhe viktimë e modelit shoqëror-jo vetëm e thikës-, nuk u vra në këtë debat që ne bëjmë prej kohësh me shkrim e me gojë.

Por, vdekja e tij lidhet pazgjidhshmërisht me këtë plagë shoqërore.

Atij që nuk i jepet, por merr, nuk jep as llogari. Vetëm kërkon. Nga të tjerët, kurrë nga vetja. Këtë here, si përherë, nuk po i lyp llogari opozitës, Saliu dhe as popullit, por Tik Tok-un.

Të mbyllësh Tik Tok-un nuk është masë, është maskë për të fshehur trupin e përgjakur të Martin Canit dhe fytyrën e keqe të Ramës dhe ministrashave të tij që ngazëlleenin kur në Kuvend kërkohej një minutë heshtje për 14 vjeçarin.



SONILA MEÇO

Për shuarjen tragjike të Martinit, duhej të kishin dhënë dorëheqjen drejtuesit më të lartë të vendit, motivuar fillimisht nga të qenurit njerëz, prindër e mandej zyrtarë përgjegjës. Nuk e bënë, siç nuk e kanë njohur kurrë llogaridhënien.

Ndoshta nuk e dini ende, ose e shmangni me vetëdije, por lajmi i vërtetë është: Autori i vrasjes nuk është thjesht Mario, 14 vjeçar. Ai kishte bashkëpunëtorë të fuqishëm. Dhe viktimat nuk do të ndalen me

kaq.

A doni të njihni të gjithë autorët dhe armën e shkatërrimit në masë për këtë brez e dhjetëvjeçarët e ardhshëm? Për fëmijët tanë, fëmijët e tyre e deri tek stërnipërit? A doni të dini çfarë njetesh "shfarosëse" na kërcënojnë mbi krye si shqiptarë? Provat janë administruar në flagrancë, i gjeni në foto, aty është arma letale, genocidi, krimi masiv mbi një komb.

Prova, që do çonte në gjyqin më të madh në histori çdo vendim-marrës e drejtues përgjegjës: Testi PISA.

Testi PISA është një nismë mbarëbotërore e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik, OECD, për të matur aftësinë e nxënësve 15-vjeçarë për të përdorur njohuritë e tyre në matematikë, shkencë dhe lexim.

Testet eksplorojnë se sa mirë nxënësit mund të zgjidhin probleme kom-

plekse, të mendojnë në mënyrë kritike dhe të komunikojnë në mënyrë efektive, duke dëshmuar se si sistemet arsimore të vendeve ku studiojnë i përgatitin ata për sfidat e jetës reale.

Dhe e dini cilat janë gjetjet e sivjetme?

"Hendeku i performancës në të menduarit krijues midis vendit me performancën më të lartë dhe me performancën më të ulët është shumë i madh, rreth 28 pikë. Si kurrë më parë. 5 vendet me performancën më të ulët janë Shqipëri, Filipine, Uzbekistani, Maroku dhe Republika Domenikane."

Bazuar në raportin e detajuar, Shqipëria ka rënie në të gjithë treguesit krahasuar me rezultatet e veta në vitin 2018. Rënia nuk është vetëm në tre fushat e testimit (matematikë, shkencë dhe lexim) por edhe në tregues të tjerë, përfshi ato që i ndajnë nxënësit sipas kriterëve ekonomike.

Raportuesit e theksojnë këtë fakt me nota dramatike, duke e cilësuar si rënie më të madhe që PISA kishte regjistruar në histori, përgjatë kohës që zhvillohet ky testim: "Këto modele sugjerojnë se rënia e performancës së Shqipërisë – një nga më të mëdhatë të regjistruara ndonjëherë në PISA – reflekton, të paktën pjesëshëm, mungesën e angazhimit të nxënësve".

Dhe meqë drejtuesve tanë u pëlqejnë krahasimet me 2012-ën, kohë pas së cilës erdhën në pushtet absolut, raportit u vë në duar dëshmitë e "krimit" bërë prej tyre. Bazuar në grafikët e raportit, rezultatet e Shqipërisë në matematikë dhe shkencë ranë poshtë atyre të arritura në vitin 2009. Në të dyja degët nxënësit kanë shënuar pak mbi nivelin e 350 pikëve. Rënia në shkencë është edhe më e madhe.

Po ta shtyj pak më tej, tragjizmin e pasojave të këtij lëshimi qeverisë ndaj arsimit, kujtoj se shkolla është ende vetëm një pjesëz e edukimit, që

përfitohet përtej atyre mureve: familje, kulturë, art, aktivitete shoqërore, sporte, media, infrastrukturë për zhvillimin krijues e deri tek parqet, gjelbërimi, oksigjeni, rrugët, peizazhi i një qyteti, fshati.

Sado të kushtojnë këto, mbeten ende të lira në raport me kostot e injorancës, që po mbjell egër një shtet i pilotuar drejt humnerës, me pasagjerë, që hidhen nga dritare e dyer të shqyera dhe të tjerë, që shpresojnë se sedilja e tyre do t'u shpëtojë të ndenjaturat.

Ja ku e keni provën shqiptarë të mirë e të ndershëm, të ikur a mbetur, militantë a indiferentë, patronazhistë a frikacakë, të blerë a shitur, të nënshtruar a trima...po mbillet helmi, si mund mos të shohësh gjëmën?

Edhe sa Martinë do duhet të durojnë thikën në palcë, që ashti i kombit të thyhet përgjithmonë?

Që fëmijët mos themi më se i sjellim në jetë, por në ferrin, që ndërtaam vetë.

TË KAPUR NË FLAGRANCË: VRASËSIT E KOMBIT!

DORIAN KOÇI

Zhvillimi i shpejtë i lëvizjes kulturore pas vitit 1908, kërkoi si nevojë të ngutshme caktimin e një alfabeti të vetëm për shkrimin e shqipes. Nismën për thirrjen e tij e mori klubi "Bashkimi" i Manastirit.

Në një thirrje të klubit "Bashkimi" thuhej: "Ora e Lumtur erdhi, kur ne fillojmë punojmë të lirë dhe të papenguar për lumturinë e kombit tonë, jo me armë dhe barut, por me penë dhe me letër. Ne duhet të fillojmë me çështjen e alfabetit - sepse ndryshe nuk do të arrijmë qëllimin e lartë - përparimin e gjuhës sonë". (Peter Bartl, Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësinë kombëtare (1878-1912), Dituria, Tiranë: 2006, fq. 201.)

Më 14 nëntor 1908 hapi punimet Kongresi i Alfabetit ose ndryshe Kongresi i Manastirit, në të cilin morën pjesë 50 delegatë, ku 32 ishin me të drejtë vote dhe 18 të tjerë si pjesëmarrës, të cilët nuk e gëzonin të drejtën e saj. Kongresi i Manastirit u shndërrua në një kuvend të vërtetë mbarëshqiptar, në të cilin morën pjesë delegatë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, nga qytetet e të katër vilajeteve, si edhe nga shoqëritë shqiptare të Bukureshtit, të Sofjes, të SHBA, të

Egjiptit, etj. Ndërmjet delegatëve ishin edhe patriotët e intelektualët e shquar si: Luigj Gurakuqi, Mid'had Frashëri, Gjergj Fishta, Mati Logoreci, Hilë Mosi, Shahin Kolonja, Sotir Peci, Fehim Zavalani, Gjergj Qiriazi etj.

Kongresi i Manastirit i zhvilloi punimet në shtëpinë e patriotit Fehim Zavalani. Kryetar i Kongresit të Manastirit u zgjodh Mid'had Frashëri, i cili u caktua edhe në Komisionin e alfabetit. Kongresi kishte si qëllim kryesor forcimin e unitetit kombëtar, njësimin e alfabetit, njohjen e të drejtave për shqiptarët dhe organizimin e veprimtarisë arsimore e politike në shkallë kombëtare. (Nuri Dragoi, Arsimi në Përmet, West Print, Tiranë: 2015, fq. 29)

Gjatë dy ditëve të para të Kongresit u caktuan mbledhje të gjera e të hapura për popullin, ku përveç intelektualëve morën pjesë edhe nxënës shkollash, si edhe banorë të qytetit të Manastirit. Këto mbledhje u shndërruan në man-

KONGRESI I MANASTIRIT: EUROPIANIZIMI I KULTURËS SHQIPTARE NË FILLIM TË SHEKULLIT XX



ifestime kombëtare, në të cilat u mbahtën fjalime patriotike, për nevojën e bashkimit të të gjithë shqiptarëve, gegë e toskë, myslimanë e të krishterë. (Akademia e Shkencave, Historia e Popullit Shqiptar, vëll. II, Toena, Tiranë: 2002, fq. 392.)

Vendin kryesor në punimet e Kongresit e zuri çështja e caktimit të një alfabeti të përbashkët për të gjithë shqiptarët. Gjatë diskutimeve të zhvilluara pjesa më e madhe shfaqti mendimin se alfabeti që duhej të vendosej duhej të kishte si bazë shkronjat latine. Alfabeti latin shihej nga shumë përfaqësues liberalë si mënyrë për t'i bashkuar shqiptarët dhe që do t'i bënte më të ndërgjegjshëm ata për trashëgiminë e tyre. (Miranda Vick-

ers, Midis Serbëve dhe Shqiptarëve, Toena, Tiranë: 2004, fq. 92.)

Edhe Mid'had Frashëri ishte për një alfabet latin. Pas diskutimeve të shumta, lidhur me alfabetin, u krijua edhe një komision prej 11 vetësh, me patër Gjergj Fishtën si kryetar (Peter Bartl, Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësinë kombëtare (1878-1912), Dituria, Tiranë: 2006, fq. 201), i cili nuk arriti të konkludonte në një përfundim për njësimin e alfabetit. Vendimi kryesor i Kongresit ishte miratimi i dy alfabeteve: ai i Stambollit dhe i alfabetit të përbërë vetëm me shkronja latine.

Vendimi për të përdorur bashkarisht dy alfabete u mor për të mos shkak-

tuar përçarje në radhët e delegatëve dhe të shqiptarëve në përgjithësi. Kongresi ndonëse nuk caktoi një alfabet të vetëm ishte një hap i rëndësishëm përpara në rrugën e zgjidhjes përfundimtare të çështjes së alfabetit dhe ushtroi një ndikim të fuqishëm në bashkimin politik dhe përparimin e mëtejshëm kulturor të popullit shqiptar.

Atë që nuk e çoi dot deri në fund Kongresi i Manastirit, e zgjidhi përfundimisht vetë jeta e popullit shqiptar. Alfabeti latin duke qënë homogjen e më i lehtë e praktik për shtyp, u përhap gjithnjë e më shumë dhe nga fundi i Luftës së Parë Botërore u bë alfabeti i përbashkët e i vetëm për të gjithë shqiptarët.

Kongresi miratoi edhe një program kombëtar prej 18 pikash, që përmbante kërkesa me karakter politik, ekonomik dhe kulturor. Kërkesa të tilla ishin njohja zyrtarisht e kombësisë shqiptare dhe e gjuhës shqipe, përhapja e arsimit në Shqipëri, krijimi i një universiteti etj.

Kongresi i Manastirit për çështjet që diskutoi e zgjidhi vlerësohet me të drejtë si kuvendi më i rëndësishëm kombëtar në historinë politike e kulturore të shqiptarëve në fillim të shekullit XX dhe Kongresi kombëtar që i hapi udhën evropianizimit të Shqipërisë.

POROSISNI BANNERIN PËR BIZNESIN TUAJ

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dotech
website

ARMAND SHKULLAKU

Shembulli dhe modeli i Rilindjes janë sot deformimi më i madh që po i bëhet shoqërisë shqiptare

Kryeministri-artist shpalli sot përpara shqiptarëve dilemën e tij të madhe nëse duhet të vendosen filtra sigurie për rrjetet sociale apo duhet marrë një vendim drastik, siç tha ai, për mbylljen e plotë të tyre. Tronditja shoqërore që shkaktoi vrasja e një 14 vjeçari nga një bashkëmohatar i tij, pranë një shkolle në mes të Tiranës, e detyroi Edi Ramën të dilte vetë sot personalisht përpara kamerave, pas mbledhjes së qeverisë. Dhe, në pamundësi që për këtë rast të deklaronte se fajin e ka Saliu dhe opozita, shpalli pretendencën për Tik Tokun dhe Snapchat-in.

Sigurisht që ngjarje të tilla tragjike nuk bëjnë automatikisht me faj qeverinë, ato mund të ndodhin kudo në botë. Përgjegjësia e atyre që janë zgjedhur për të drejtuar, konsiston në sistemin edukativ që ndërtojnë dhe masat efikase që premtojnë të marrin për të rritur sigurinë. Por të dalësh para qytetarëve dhe këto përgjegjësi t'ia kalosh Tik Tokut, duke lënë të kuptohet se qeveria ka bërë gjithçka dhe mbyllja e plotë e disa rrjeteve sociale do e zgjidhë problemin e dhunës në shkolla, është skuthëri politike dhe pandjeshmëri ndaj një tragjedie.

Edi Rama nuk ka zbuluar ujin e nxehtë duke thënë se disa platforma online nxisin dhunën. Por ai nuk është kryeministër për të përsëritur analizat e sociologëve e psikologëve. Ai në radhë të parë duhet të analizojë se çfarë modeli i ka ofruar shoqërisë në 12 vite qeverisje, si edukativ ashtu edhe social.

A ka përgjegjësi Tik Toku për nivelin e degraduar arsimor e edukativ këto 10 vitet e fundit? Për mashtrimin e 2013-ës se buxheti i arsimit do të shkonte në 5 përqind të GDP me ardhjen e Rilindjes në pushtet? Po për kullëzimin e terreneve sportive, kin-



mave, qëndrave kulturore e rekreative? Shqipëria ka njohur një rënie të lirë si në cilësinë e arsimit ashtu edhe në krijimin e mjedisit të shëndetshëm e të sigurtë për edukimin e brezit të ri. E këtu futet edhe siguria në shkolla, ku çdo ditë raportohet për akte dhune, shitje e përdorim narkotikësh e deri tek mbajtja e armëve. Mbyllja e Tik Tokut vështirë të jetë zgjidhja për këto fenomene, pavarësisht idesë gjeniale të Edi Ramës.

E sa i takon modelit social që disa

platforma si Tik Toku ofrojnë, duke shkaktuar devijime të rrezikshme, është mëse e vërtetë, por ato janë ku e ku më të papërfillshme në krahasim me modelin që Rilindja i ka imponuar shoqërisë shqiptare në përgjithësi dhe të rinjve në veçanti. Gjuha e dhunës, bullizuese, seksiste e denigruese e kryeministrit ndaj kundërshtarëve politikë, lë pas edhe tiktokerët më të zellshëm në këtë fushë. Zgjedhjen dhe promovimin si përfaqësuesit më të lartë të qytetarëve në Parlament, pushtet lokal dhe qeveri, të kriminelëve, banditëve dhe hajdutëve, nuk

ka platformë online që ta promovojë si model më mirë se sa Rilindja. Deputetë që qëllojnë me armë, që godasin me grushta në Kuvend, që paguajnë për vrasje, që trafikojnë drogë, strehojnë vrasës e blejnë vota. Të zgjedhur lokalë që dhunojnë me shkopa bejsbolli e kërcënojnë me armë, ministra që vjedhin edhe të sëmurët në spitale e kryebashkiakë që rruajnë paratë e buxhetit direkt për xhepat e tyre. Drejtorë e shefa që zhvasin taksat e qytetarëve për llogaritë e kompanive të tyre private apo për të mbushur tubat e aspirimit. A ka plat-

KUR RAMA ANKOHET SE FAJIN E KA TIK TOKU

formë në botë që mund të ndikojë si model sukcesi tek të rinjtë më shumë se sa kjo e Rilindjes?

Nëse kryeministri nuk do të marri përgjegjësinë që i takon si për modelin edukativ ashtu edhe atë social që ka instaluar në këto 12 vite, më e ndershme do të ishte të heshte se sa të shpallte "masa drastike" për mbylljen e plotë të Tik Tokut e Snapchatit. Sepse nuk ka platformë virtuale që mund konkurrojnë me atë reale të Rilindjes. Fotot dhe videot e Edi Ramës and co nëpër fushata me këngëtarë, që jo vetëm predikojnë dhunë por janë dhe vetë të përfshirë në të, madje që edhe sponsorizohen në rrjet për t'u shpërndarë sa më shumë, ku ndryshojnë nga mesazhe të ngjashme në Tik Tok? Po transformimet estetike të ministereve e drejtuesve të shtetit që shteruan krejt botoksin dhe e kanë shndërruar parlamentin dhe qeverinë në sallon mode, a kanë më shumë ndikim se sa manekinet që fryjnë buzët në Instagram?

Për të mos folur pastaj për hipokrizinë e një kryeministri, që përgjegjësinë për sigurinë në shkollat shqiptare do t'ia rrasë Zuckerbergut apo kinezëve, ndërkohë që ai vetë dhe oborri i tij, i kanë fëmijët në shkolla private, madje duke i garantuar në trafik edhe me policinë e shtetit.

Shembulli dhe modeli i Rilindjes janë sot deformimi më i madh që po i bëhet shoqërisë shqiptare, i cili nuk mund të mbulohet me fajin e ka Tik Toku. Edi Rama mund të mbylli gjithçka dëshiron në këtë vend, madje pa patur dilema fare, i ka mundësitë. Por ai nuk mund të mbyllë dot kurrë sytë e njerëzve, para të cilëve është përgjegjësi real dhe jo virtual i dramës që po jetojnë. /Lapsi

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



“THE GUARDIAN”: DËSHTIMI I MARRVESHJES MELONI RAMA

“Policia italiane dhe punonjësit socialë largohen nga Shqipëria pas boshatisjes së qendrave të emigrantëve”. E përditshmja britanike “The Guardian” i ka kushtuar vëmendje “dështimit” të marrëveshjes Rama – Meloni për qendrat e emigrantëve në Gjadër dhe Shëngjin. Sipas shkrimit të medias britanike që lapsi.al e sjell të plotë më poshtë “qendrat qëndruan hapur për më shumë se një muaj, por pranuan vetëm 24 azilkërkues, ndalimi i të cilëve u konsiderua i paligjshëm”.

Dhjetëra oficerë policie dhe punonjës socialë italianë të vendosur nga qeveria e ekstremit të djathtë të Italisë në qendrat e emigrantëve në Shqipëri janë kthyer në shtëpi, pasi rezultoi se objektet, e vlerësuar si një model për të reduktuar ardhjet e refugjatëve, kanë qenë bosh prej javësh.

Pak më shumë se një muaj pas hapjes së shumë-publikuar të qendrave të paraburgimit që kushtuan miliona euro për azilkërkuesit në Shqipëri, të cilat supozohej të pranonin deri në 3 mijë persona në muaj, më shumë se 50 oficerë policie u kthyen në Itali dy javë më parë, ndërsa dhjetëra punonjës socialë janë larguar gjatë fundjavës, pasi prania e tyre në Shqipëri është cilësuar si “të panevojshme”.

Që nga hapja e tyre më 11 tetor, vetëm 24 azilkërkues janë dërguar në qendrat në Shqipëri, me qëllim riatdhesimin e tyre në vendet e origjinës. 5 kaluan më pak se 12 orë në një nga qendrat e paraburgimit ndërsa pjesa tjetër qëndruan për pak më shumë se 48 orë.

Të gjithë u transferuan në Itali pasi



gjyqtarët italianë e konsideruan të paligjshme ndalimin e tyre në Shqipëri përpara riatdhesimit në vende, si Bangladeshi dhe Egjipti, të konsideruara si “të sigurta” nga Roma. Duke vepruar në këtë mënyrë, gjyqtarët u mbështetën në një vendim të 4 tetorit nga gjykata e drejtësisë e BE-së (GJED) se një vend jashtë bllokut nuk mund të shpallej “i sigurt” nëse i gjithë territori i tij nuk konsiderohej “i sigurt”.

Si rezultat, qendrat, të prezantuara nga presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, si një model i ri për krijimin e qendrave të përpunimit dhe ndalimit për azilkërkuesit jashtë BE-së, janë

bosh prej më shumë se një muaji. Në një kohë kur qeveria italiane po përpiqet të balancojë buxhetin – duke shkurtuar fondet për arsimin, shëndetësinë dhe sigurimet shoqërore – partitë opozitare e kanë përshkruar marrëveshjen, që do të kushtojë rreth 1 miliard euro gjatë 5 viteve, si një “katastrofë financiare”.

“Misioni u krye!” – tha Riccardo Magi, presidenti i partisë së majtë opozitare “Più Europa” (Më shumë Evropë). “Qeveria ka pasur sukses mbi baza nudokratike. Emigrantët? Jo, operatorë italianë të dërguar në Shqipëri, të cilët do të kthehen në shtëpi brenda fundjavës.

Qeveria fillimisht shpenzoi një shumë të madhe fondesh publike, më pas me qendrat e zbrazura, solli disa punonjës policie në Itali dhe tani edhe punonjësit socialë po kthehen në shtëpi. Ky është një dështim epokal.”

Skema ka çuar në një përplasje mes qeverisë italiane dhe gjyqtarëve, të cilët janë akuzuar nga partitë e ekstremit të djathtë për pengim të projektit.

Nicola Gratteri, kryeprokurori i Napolit dhe një nga gjyqtarët më autoritarë në Itali, tha në një intervistë televizive këtë javë: “Ne duhet të ndalojmë së sulmuari gjyqtarët vetëm sepse nuk na pëlqen një

vendim. Nuk dua të jap një gjykim politik, por them se në këtë moment në Shqipëri janë 250 oficerë ligjzbatues që mezi po bëjnë asgjë. Është humbje të mbash 250 oficerë policie në një mision në Shqipëri, ndaj mendoj se ata duhet të kthehen në Itali ku po luftojmë me mungesën e personelit për mijëra policë”.

Qeveria italiane ka thënë se qendrat në Shqipëri “do të mbeten të hapura dhe funksionale” dhe se transferimet në Itali janë bërë sipas nevojave të personelit. Megjithatë, besueshmëria e kryeministres së Italisë, Giorgia Meloni, është në rrezik pasi ajo e bëri emigracionin një çështje qendrore të fushatës. Në të kaluarën ajo ka kritikuar paraardhësit për shpenzimin e parave publike për menaxhimin e krizës së migracionit. Transporti nga deti në një anije ushtarake italiane me vetëm 8 burra që mbërritën në Shqipëri gjatë një fundjave në mes të nëntorit kushtoi 250,000 €, më shumë se 31,000 € për një azilkërkues në bord.

Elisabetta Piccolotti, një deputete e partisë së Aleancës së Gjellbër dhe të Majtë, u shpreh: “Qeveria ka dështuar duke e ditur se do të dështonte. Ata kanë shpenzuar një mal me para dhe kanë luajtur me të drejtat e njerëzve. Kjo do të mbetet në histori si një faqe e turpshme për vendin tonë.” ©The Guardian, Përgatiti LAPSI.al

ALFONS ZENELI

Në Ditën Ndërkombëtare të Televizionit)

Televizioni është malli më i lakmuar i një shoqërie boshe siç është me kohë të plotë shoqëria shqiptare. Sepse zbrazëtia shpirtërore është e lidhur ngushtë me të jashtmen. Leximi vs grim, dituria vs botox, truri vs cica. Ky është konflikti në ringun e shoqërisë tonë, kjo është ndeshja e përditshme të cilën e fitojnë gjithmonë grim, botox-i dhe cikat. Kjo për meritë të padiskutueshme edhe të Televizionit si institucion.

Media, ku përfshihet dhe Televizioni, e ka për detyrim ligjor dhe moral që të luajë rol edukues, por siç e dimë dhe e shohim çdo çast, ai luan rol të kundërt i patrazuar nga askush. Përse? Sepse shteti është në të njëjtën frekuencë antiestetike dhe antivlere. Sepse kryeministri është fans dhe promovues i Noizit, sepse Noizi shfaqet në tekste shkollorë si idhull, sepse

tekstet e këngëve të tij janë reklamë dhe inspirim për dhunë, armë zjarri e të ftohta, kokainë. Sepse një prej prezantuesëve më në zë të ekranit shqiptar deklaroi: “kur isha e adoleshente u magjepsa nga brekushet e guximshme dhe çorapet vezulluese të kryeministrit”. Sepse nëpër spektaklet e televizioneve kombëtarë çdo analfabet i zhveshur cullak popmpohet si VIP dhe i serviret si shembull rinisë. Sepse pronarët e mediave vizive nuk kanë ndonjë ndryshim esencial nga “VIP”-at e prodhuar ku-klarave degraduese që ata financojnë. Sepse titujt e kronikave kulturore artistike nuk shkojnë dot përtej sensacioneve antiart e antikulturë të tipit “Këngëtarja X çmend publikun me të brendshmet e saj”, apo “Këngëtarja Y

del në skenë pa të brendshme”. Kështu këto media injektajnë idenë se kënga si art është në fakt një garë resursesh truporë duke instaluar në psikikën e rinisë një sistem vlerash mbi baza nudokratike. Dhe pasojat e një apokalipsi të tillë të shkaktuar me dashje artificialish janë të dukshme. Therja për vdekje e 14 vjeçarit është pasojë e këtij apokalipsi mbi vlerat. A e patë dhe videon e atij të riut në TikTok që ishte frymëzuar nga akti “heroik” i vrasësit? A e vutë re pasionin e tij shtazarak për ngulje thikash? Ishte identik me tekstet e këngëve të Noizit, VIPI-it të preferuar të qeverisë.

Në lokalitë e lagjes ku pi kafe, çdo orë 12 vijnë rreth 30 nxënës të një shkolle. Shumica 14 vjeçarë. Të gjithë

(90%) konsumojnë duhan. Vajzat edhe më keq akoma. Në 10 fjali të vajzave, 8 fjali shoqërohen nga shprehja “me rob shpie” dhe me fjalë të tjera me të njëjtën valencë. Ndërsa djemtë të gjithë të veshur stil reperash, 10/10 fjali i shoqërojnë me “trimëri” me shprehjen “nuk e çaj k..in”. Sigurisht në prani të vajzave. Deri në orën 15.00 kryejnë të njëjtin ritual. Përditë. Nuk i kam dëgjuar KURRË të bisedojnë për ndonjë libër. Para pak minutash, njëra nga vajzat kërcëu me vrull mbi mbështetësen e kolltukut dhe zgjati rrëmbimshëm dy pëllëmbët e duarve drejt shoqeve dhe shokëve. Mendova mos Noizi ka hedhur në treg ndonjë model të ri trendy përshëndetjeje. Por jo. Iu tregoi manikyren e re mbi thonj. Të gjithë spektatorët ulëritën duke

shfryrë dhe tymin e cigareve. Imagjinoni kur të bëhen 20-25 vjeçarë, apo kur të bëhen prindër.

Televizioni (televizionet shqiptarë) kanë meritën kryesore në ndërtimin e një ngrehine të tillë të pistë e të shëmtuar. Por edhe Televizioni si institucion është produkt i po kësaj shoqërie. Shoqëria e prodhon, e klikon, e mban gjallë. Televizioni e ushqen me atë lloj malli toksik e narkotik i cili e lidh edhe më shumë me Televizionin. Dhe kështu gjendemi në një spirale tragjike e cila na mban të pashpresë në këtë ngecje fatale ku truri është në vend të cicaeve dhe cikat në vend të truve.

Televizioni është “adoleshenti” që po ngul thika mbi trupin e shoqërisë.

TELEVIZIONI, “ADOLESHENTI” QË PO NGUL THIKA MBI TRUPIN E SHOQËRISË

IRENA BEQIRAJ

Në vitin 1999, Andrew Lawrence, një analist i pronave që punonte në Barclays Capital shkroi një punim me titull "Indeksi i Rrokaqiejve: Kullat e Gabuara". Raporti nuk u publikua, por ai argumentonte një "parim të përgjithshëm ekonomik" që ndërtesat shumë të larta shfaqen në kulmet e cikleve ekonomike. Ndryshe, kullat janë simbole prej qelqi e çeliku të asaj që ekonomisti Alan Greenspan më vonë do ta quante 'bollëku irracional'.

Historia tregon se ndërtimi një serie rrokaqiejsh, ndërtesa me lartësi rekord janë pasuar nga kriza financiare. Ajo tregon jo vetëm që ka një korrelacion midis të dyja ngjarjeve, por edhe shkalla e rritjes së lartësisë së një ndërtese mund të jetë një matje e saktë e shtrirjes së krizës që pason.

Nga rrokaqiejtë që paralajmëruan kriza mund të përmendim: Rrokaqielli i parë në botë, ndërtesa Equitable Life e Nju Jorkut, 166 metra, u përfundua në 1873 ne prag të recesionin pesë-vjeçar nga 1873-1878.

Ndërtesa Singer, 187 metra e gjatë dhe Kulla e Kompanisë së Sigurimeve Metropolitan Life, 247 metra, u hapen në Nju Jork gjatë panikut të vitit 1907, përkatësisht në 1908 dhe 1909. Met Life mbeti ndërtesa më e lartë në botë deri në vitin 1913. Empire State Building, 443 metra e gjatë, u lançua në vitin 1931, pak para renies së Wall Street të vitit 1929. Ndërtesa e Chrysler, 319 metra, u hap për publikun gjithashtu në vitin 1929.

Kullat e Qendrës Botërore të Tregtisë (541 m) dhe Sears Tower (442 m), u hapën në vitin 1973, gjatë rrezimit të bursës 1973-1974 dhe krizës së naftës 1973. Kullat Binjake Petronas, 452 m të larta, u hapën para krizës fi-



nanciare aziatike 1997 dhe mbajtën rekordin botëror të lartësisë për pesë vjet.

Burj Khalifa, 828 metra i lartë, u hap në vitin 2008, në kulm të Recesionit të Madh të 2007-2009. Hapja e saj u shoqërua nga falimentimi i fondit më të madh të investimeve në Emiratet e Bashkuara.

Në pamje të parë kjo duket si një rastësi historike interesante madje intuitivisht kjo mund të duket edhe e gabuar. Kullat e larta shpesh konsiderohen si simbol i suksesit ekonomik dhe financiar, si kulmi zhvillimit edhe si triumfi i racionalitetit. Ato jo rrallë herë shihen nga njerzit si produkt i sistemeve të

sosfistikuara, të planifikimit, financimit, projektimit edhe ndërtimi. Por arsyet përse ndërtimi i tyre mund të parashikojë një kolaps ekonomik nuk janë të vështira për t'u shpjeguar.

Duke qenë se duhet shumë kapital për të financuar një kullë të lartë, ndërtimi i tyre ndodh vetëm në kohët kur paratë janë "të lehta" për t'u siguruar, dhe kur investitorët kanë humbur racionalitetin, duke besuar se cmimet e paradoksalisht të larta do të vazhdojnë edhe përfirtueshmëria do të jetë e lartë.

Në një analizë e vitit 1995, Carol Willis, themeluesja, drejtoresha dhe kuratorja e Muzeut Rrokaqiejve në Manhattan, zbuloi se "ndërtesat më të

larta në përgjithësi shfaqen menjëherë në fazën e fundit të një "lulëzimi". Lartësia e tyre është prova se ethet spekulative edhe irracionaliteti kanë prekur si zhvilluesit ashtu edhe financuesit e tyre" sipas saj rrokaqiejt shfaqet kur rritja ekonomike shteron dhe ekonomia është para krizës.

Shqipëria po ashtu është futur në fazën e Rrokaqiejve. Kjo shton dyshimet për ekzistencën e një flucke në sektorin e pronave të paluajtshme, por jo vetëm.

Edhe pse vlera e gjithë pasurive të paluajtshme në Shqipëri vlerësohet rreth 84 miliardë USD ose rreth 3.2 herë më shumë se PBB -ja, (SHBA e ka ketë raport 1.6 herë), oferta po

vazhdon të rritet, shitjet po ngadalësohen edhe cmimet por edhe kostot e ndërtimit po rriten. Ndërkohë që 53 mijë apartamente janë bosh, qiratë shumë larta, edhe cmimet e papërbalueshme të banesave e mbajnë një pjesë të konsiderueshme të popullatës në moshtë të re jashtë këtij tregu.

Ndërkohë që të ardhurat reale të disponueshme nuk janë rritur, rritja e flukseve hyrese të kapitalit që investohet kryesisht në ndërtim, edhe optimizmi se cmimet do të vazhdojnë të rriten ka çuar në një mbiinvestim në këtë sektor. Ky lulëzim ekonomik i sektorit është artificial dhe i paqëndrueshëm.

Formulat e pranura gjerësisht për të vlerësuar performancën e një projekti ndërtimi në kohë "normale" nuk funksionojnë më. Sjelljet racionale ia lënë vendin sjelljes iracionale; blerësit vënë bast mbi kërkesën dhe qiratë gjithnjë në rritje dhe janë të gatshëm të paguajnë më shumë sesa do të bënin normalisht. Kjo shpërndarje e gabuar të kapitalit, me shumë gjasa do të rezultojë në një krizë të sektorit, thellësia e së cilës do të varet nga sasia e kreditimit, e cila po ashtu po njej rritje.

Sigurimi i status-quo nëpërmjet madhësisë së ndërtimeve është qasje e vjetër edhe historia është provuar të jetë gjithmonë e pagabueshme. Vizioni e për të ndërtuar madhësitë e një qyteti shpesh përfundon si një kujtesë e arrogancës, lakmisë dhe pritshmërive të pamundura.



NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

ANDI BUSHATI

PJELLAT ZVARRANIKE TË REFORMËS NË DREJTËSI

Zakonisht regjimet autokratike mbështeten në dy grupime njerëzish: tek kamikazët, që janë gati të hidhen në zjarr për ti shërbyer dhe tek skuthët të cilët i përkrahin në heshtje, duke qenë njëkohësisht të turpëruar që ta bëjnë publikisht këtë. Në kontekstin tonë aktual, këto dy profile individësh i rinxori në sipërfaqe reforma në drejtësi. Të parët përfaqësohen nga spakistët, ushtarë të bindur të idesë se Shqipërisë i duhet një sistem me zgjedhje farsë, me opozitë të masakruar dhe me kryeministër mbi ligjin, që presupozohet të veprojë për të gjithë njësoj.

Veçanësisht qëndron tek të dytët. Përditë e më shumë konfigurimi i tyre po merr tiparet e fytyrës së anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Shumica të paafitë deri në kufijtë e injorancës, të pa karakter deri në përcudnim, meskinë, aq sa të mos ngrihen përtej hallevë të tyre të vogla, ata simbolizojnë arketipin e qytetarit amebë që promovoi reforma euro atlantike. Një provë për këtë e dhanë së fundi edhe me mënyrën si u sollën në procesin e Sali Berishës.

Kur pas orësh të gjata diskutimesh, në një sallë të mbyllur, vendosën të komunikojnë vendimin që kishin marrë, ata ngjallën më shumë paqartësi dhe konfuzion. Në media rrodhën lajmet e para se kushtetuesja i kishte dhënë pjesërisht të drejtë liderit të opozitës.

Se ajo e kishte quajtur gabim kufizimin për sekuestrimin e pashportës, ndërkohë që e konsideronte të arsyeshme masën e detyrim paraqitjes. Aq e turbullt ishte situata sa një reportere e spikatur e kronikës e përcaktoi këtë vendim si “as mish, as peshk”.

Madje në momentet e para, disa gazetarë, pyetën të habitur njëri-tjetrin, se mos për Berishën po përfundonte arresti. Në media u shfaqën titujt e parë se gjykata i paskësh dhënë atij të drejtë për gjysmën e pretendimeve.

Në fakt, realiteti ishte krejtësisht i ndryshëm. Verdikti që i qartë se, lideri i opozitës duhej të mbahej në izolim dhe se procedura e ndjekur nga SPAK dhe GJKKO, për të shmangur lejen e parlamentit në rastin e kufizimit të lirisë së një deputeti, që ajo e duhura.

Pra, nëse do i përgjigjeshe në mënyrë të vulgarizuar pyetjes së një qytetari nëse ia mbajti apo ia hoqi kjo gjykatë masën Berishës ajo do të qe: e la në arrest.

Atëhere pyetja shtrohet: po si qe e mundur që nga një vendim kaq i thjeshtë u krijua një paqartësi kaq e madhe? Këtu dalim sërish tek karakteri prej zvaranikësh i anëtarëve të kushtetueses. Tek truku i komunikimit që ata ndoqën për të shitur të



zëzën si të bardhë. Po të lexosh dizpozitivin e vendimit që bënë publik, të shkruar enkas me një gjuhë hermetike, aty i jepej më shumë prioritet një çështjeje anësore të procesit, si ajo e proporcionalitetit të masave ndaj liderit të opozitës, dhe jo thelbit të kërkesës së tij, që mëtonte të dinte, nëse arrestimi ishte apo jo në përputhje me kushtetutën.

Duke përdorur këtë legjllëk në komunikim ata arritën të krijojnë konfuzion, ndërkohë që në realitet, kishin marrë një vendim krejtësisht kundër Berishës. Madje për të realizuar urdhërin që po zbatonin, arritën deri në asurditete të tilla sa të rishkruajnë kushtetutën, për të interpretuar se lëvizja e lirë nuk bën pjesë në liritë e njeriut.

Nejse, pa hyrë në detaje, askush nuk

priste të ndodhte ndryshe nën në një regjim ku po fiket privilegji për të vepruar dhe për tu sjellë sipas bindjeve që ke. Përveç naivëve që vetëm fizikisht jetojnë në këtë vend, të gjithë e dinin fatin që e priste Berishën. Anëtarët e kështetueses, që qëndrojnë në profesionalizëm dhe dinjitet shumë më poshtë paraardhësve të tyre tashmë të nxjerrë nga sistemi (që i zbrapsën me dhjetra ligje dhe PD dhe PS kur ishin në pushtet), kanë dëshmuar se janë thjeshtë masha të qeverisë.

Si në çështjen Xhaçka që e shtynë në kalendat greke për të mos e zgjidhur kurrë, si në ankimin e 1/6 të deputetëve opozitarë për imunitetin e Berishës, që refuzuan ta shqyrtojnë edhe tek Butrinti apo tek pakti Rama-Meloni, ku i njollosoi me turp krahasimi me vendimet e drejtësisë

italiane, ata janë sjellë po njësoj.

Por, thënë këtë, sërish ka një paradoks që mbetet pa spjegim. Pse kur dihet botërisht se janë të tillë, sërish reken të maskohen? Çfarë iu shërben hipokrizia e pavarësisë, kur i nënshtrohen për gjithçka qeverisë? Pse duhet të mundohen në lojra prej skuthësh, kur s'ka njëri që se di që, në fund, do mbrojnë Xhaçkën dhe do fundosin Berishën?

Përgjigjja e kësaj pyetje na kthen tek fillimi i këtij shkrimi, tek dy tipologjitë e grupimeve mbi të cilat ngrihen autokracitë.

Nëse disa gjyqtarë dhe prokurorë të posatshtëm i kanë vënë fytyrën dhe i kanë treguar gjoksin instalimit të këtij regjimi, këta të kushtetueses kanë përzgjedhur të mbulojnë surratin dhe

të fshehin menderen, duke u hequr sikur nuk e kuptojnë demin që po bëjnë.

Ata luajnë shejtan budallain gjoja pa kuptuar se e keqja nuk triumfon vetëm falë kamikazëve, por edhe si pasojë e butakëve që i duartrokin.

Ata kanë vendosur të mos kenë as minimumin e egos, asaj për ti vënë krimin emrin e tyre.

Në këtë kuptim, ata janë specija më e neveritshme që i ofroi kësaj shoqërie reforma në drejtësi, që predikoi se do forconte pavarësinë dhe dinjitetin e trupave e të reja, por polli këto qenie pa shtyllë kurizore. Falë krijesave të tilla regjimet ashpërsohen dhe prandaj Hannah Arendt i renditi ata në kategorinë specifike të banalitetit të së keqes./Lapsi.al/

SHQIPJA JONË NË FJALORIN E GJUHËVE TË BOTËS TË ANDREW DALBY – IT



MAL BERISHA

Hyrje – Kush është Andrew Dalby

Në “Fjalorin e Gjuhëve”, botuar nga Columbia University Press në New York, 1998, në mes të 400 gjuhëve të botës përfshihet edhe gjuha shqipe, si një ndër gjuhët më të vjetra indoevropiane. Kjo gjuhë zë një vend të rëndësishëm në këtë fjalor. Autori i fjalorit është Profesor Andrew Dalby, një studiues shumë i njohur anglez i lindur në Liverpul në vitin 1947.

Ai njihet si gjuhëtar, historian e përkthyes dhe ka botuar shumë libra me një gamë shumë të gjërë, që nga historia e gjuhëve klasike deri tek ajo e ushqimeve.

Profesor Dalby ka studiuar latinishten, frengjishten dhe greqishten në Universitetin e Kembrixhit dhe është fitues i shumë çmimeve sidoms për librat e botuara rreth gjuhëve të “vdekura”, atyre të folura sot dhe të kulinarisë. Dalby është marrë shumë me gjuhët e mbijetuar dhe mënyrat sesi ato kanë ardhur deri në ditët tona.

Një rëndësi të posaçme ai iu ka kushtuar gjuhëve të “vdekura” dhe e quan humbje të madhe “shuarjen” e një gjuhe jo vetëm për kombin që nuk e flet dot më, por edhe për tërë njerëzimin. Në librin e tij “Gjuha në Rrezik” ai përqendrohet tek humbja e larmisë gjuhësore dhe rreziku kanosës ndaj tyre, duke u ndaluar pikërisht tek hegjemonizmi teknologjik i anglishtes së ditëve tona.

Paralel me studimin e gjuhëve të tilla si ajo e Burmës dhe disa të tjerave nga Indokina, ai ka botuar edhe transkriptime të dorëshkrimeve të koleksioneve të vjetra skoceze. Po ashtu ai është marrë me Sanskrishten dhe me Hinduishten.

Në studimet që i bën Iliadës dhe Odisë në librin e tij “Rizbulimi i Homerit” Dalby këmbëngul se Homeri duhet parë si një autor që i takon të njejtës botë si ajo e poemave të hershme lirike greke por në një formë më aristokratike. Duke parë sesi janë skalitur në memorije dhe në shkrim këto poema, autori hedh një dyshim sikur poeti të mund të ketë qenë jo Homeri që “njojmë” ne por një grua që e ka krijuar gjithë atë vepër.

Andrew Dalby, si një njohës i shumë



gjuhëve të huaja e gjen si modelin e vet heroin persiano – armen Mithridates, Mbreti i Pontus – it, 132 – 63 p.e.re., i cili luftoi kundër romakëve por u mposht nga Pompeu. Ai fliste 22 gjuhë të ndryshme dhe është e para figurë historike e famshme për aftësitë e jashtëzakonshme në njohjen e gjuhëve.

Le të shohim sesi e ka parë dhe studiuar Gjuhën Shqipe ky personalitet i shquar i gjuhësisë botërore.

Një ndër punët e tij më të vyera është “Fjalori i Gjuhëve” i botuar në vitin 1998 i pasuar nga një liber tjetër i tij “Zhdukja e Gjuhëve”, botuar në vitin 2002. Profesor Dalby, në këtë fjalor merret me studimin e 400 gjuhëve të botës. Parakushti për të hyrë në këtë fjalor, sipas tij, ishte që gjuha të flitej të paktën nga një milion njerëz. Studimi i tij demografik e çon tek shqipja e cila e plotëson këtë kusht siç do ta shohim në studimin e tij.

GJUHA SHQIPE 5 MILIONË FOLËS NË SHQIPËRI, ISH- JUGOSLLAVI, ITALI, GREQI

Gjuha Shqipe thotë Dalby, formon një degë të veçantë të gjuhëve Indo-evropiane, krejt e ndryshme në zhvillimin e saj nga greqishtja dhe gjuhët tjera moderne fqinje. Ajo është gjuha zyrtare e Shqipërisë e folur edhe prej shumicës së banorëve të Kosovës dhe

prej minoriteteve të vendosura prej kohësh në Itali dhe në Greqi.

Emërtimi prej vendasve i gjuhës vjen nga emri i vetë vendit, pra Shqipërisë dhe gjuha quhet “Shqipe”. Ky është një emërtim i lashtë për atë vend i cili mbijeton me emrin që folësit e shqipes japin vetvetes, në Itali “Arbëresh”, në Greqi “Arvanitis” dhe në Ballkan emra të tillë si “Arnaut”. Nga të huajt emri i Shqipërisë ka dalë nga shekujt si Albania ndërsa gjuha quhet Albanian në përdorimin në gjuhën angleze dhe ndërkombëtare.

Ku ishin saktësisht folësit e gjuhës shqipe gjatë mijra viteve që kanë kaluar që kur dialektet e para Indo-evropiane filluan të rriteshin veç e veç?- pyet autori. Emrat dhe disa fjalë të tjera nga gjuhët e Ballkanit antik kanë qenë shënuar prej autorëve latinë dhe grek

. Disa prej këtyre gjuhëve, siç është ilirishtja janë reminishenca të shqipes, por asnjëra nuk është identifikuar si pararendës i gjuhës moderne. Shqipja vetë nuk gjëndej e shkruar deri në kohët e vona moderne. Perveç ndonjë fjale të vetme, e para dëshmi e shkruar mbetet “Formula e Pagëzimit”, e shkruar në vitin 1462. Po ashtu një rrjesht në shqip është thënë për heroin e një drame të shkruar në latinisht nga Thomas Medius’s Epirota dhe e luajtur në Venedik në vitin 1463, me titull: “Burri nga Shqipëria”.

Në vitin 1555 u shtyp një libër lutjesh në gjuhën shqipe. I shkruar prej Gjon

Buzukut, një prift nga Shkodra, ai përbën librin më të vjetër të njohur deri më sot nga vetë Shqipëria. Ndërsa publikimi i parë në gjuhën shqipe vjen nga Sicilia, si një libër lutjesh dhe i takon vitit 1592.

Letërsia shqipe përbëhet kryesisht nga poezia. Ajo përmban epikën gojore, e krahasueshme me atë në serbisht nga fqinji boshnjak.

Këto dhe poema më të shkurtëra ishin frymëzim për poezinë që u shtyp në gjuhën shqipe në Itali në shekullin e 17 – të, 18 – të dhe 19 – të. Rilindja Kombëtare në fundin e shekullit të 19 – të kërkonte pavarësi politike dhe zhvillimin e një gjuhë letrare të unifikuar bazuar në një alfabet të ri.

Fjalori Latin – Shqip i përpiluar nga Bardhi del në dritë në vitin 1635. Studiuesi J.H. Xylander, i cili publikoi një fjalor në vitin 1835, tregon sesi shqipja është një gjuhë Indo – evropiane.

Ai vuri re modele të rregullta siç janë ato korresponduese të shqipes si psh gj në shqip – s në latinisht, h në greqishten e lashtë. Një shembull ilustrues është fjala gjarpër që në latin është serpens, në greqisht hérypyllos, ose truma zvarranike. Fjalori bazë i shqipes është Indo – evropian: Shembull: Ne, në Latinisht bën nas, krimb, në irlandishten e vjetër bën cruim; ëndër, në greqisht bën óneiros; darkë në greqisht bën darpon; i parë, në sanskrisht bën pürvah.

Shqipëria një herë e një kohë ishte

pushtuar prej Perandorisë Romake pastaj ra nën atë Bizantine dhe më pas për pesëqint vjet ra nën Perandornë Otomane. Gjuha shqipe ka huazuar fjalë prej latinishtes, greqishtes, dhe turqishtes; P.sh, fjala djall në shqip, në greqisht bën diábolos; fjala këndoj në shqip, në latinisht bën canto, etj. Shumica e shqipfolësve janë të besimit musliman, prandaj një numër fjalësh janë huazuar prej arabishtes nëpërmjet të gjuhës së Kuranit.

Një tipar i rrallë i shqipes është përdorimi i shprehjeve perifrastike (eufemizme) për të shmangur një fjalë tabu P.sh. për fjalën “ujk” tjetri thotë mbyllizogojën, mbyllja o Zot gojën, ndërsa për “Zanën” thuhet shtojzavalle që do të thotë Shtojua o Zot vallen!

BALLKANI: KONVERGJECA DHE SUBSTRAKTI I GJUHËVE

Shqipja ka ngjashmëri të habitshme me gjuhët ballkanike, bullgarishten, serbishten, greqishten dhe rumanishten: P.sh, në shqip thuhet treg, në serbisht trg, në rumanisht tirg; Tjetër:

Në shqip thuhet shtrungë, në rumanisht strungă, në bullgarisht străga, për vendin ku bëhet mjelja e deleve; Ose, fjala i shtrembër në shqip, në rumanisht bën strîmb, ndërsa në greqisht strabós. Fjala shqipe mëz, në rumanisht bën mînz. Ndodh shpesh që e njëjta fjalë latine të përdoret në këto gjuhë me një kuptim të tjetër:

P.sh në latinisht paludem, që do të thotë kënetë, në rumanisht bën pădure, të tria me bazë fjalën shqipe pyll. Disa tipare janë të njëjta edhe me turqishten, hungarishten dhe rumanishten. Gjuhët të cilat përkojnë me një kulturë dhe shpesh janë të përdorura krahas për krahas, rriten së bashku në rrjedhë të kohës.

Kjo është arsyeja përse anglishtja, qysh nga koha e pushtimeve normane duket se ka më shumë ngjashmëri me frengjishten madje më shumë sesa e afërmja e saj gjermanishtja. Ashtu si frengjishtja dhe gjermanishtja, gjuhët ballkanike janë të lidhura vetëm për së largti në kuptimin gjuhësor të fjalës. Dhe prapë se prapë ngjashmëritë midis tyre janë befasuese deri në atë masë sa të kërkojnë edhe disa shpjegime rreth tyre.

Ato duken jo vetëm në fjalët veç e veç por edhe në tiparet bazë, siç janë përkaktorët.

Ato kanë forma të ndryshme në gjuhë të ndryshme e prapë se prapë tek të



ENVER ROBELLI

Në numrin e fundit revista NIN e Beogradit shkruan se dikur në rajon primatin në marrëdhëniet me Uashingtonin e mbanin shqiptarët e Kosovës dhe boshnjakët, ndërsa tani e ka marrë pushteti në Serbi. Si erdhi deri këtu?

Përgjigjja gjendet në Departamentin e Drejtësisë të SHBA, aty ku zyrtarë private për konsulencë duhet të deklarojnë kontratat e tyre me shtete apo organizata të huaja. NIN shkruan se pas disa viteve pauze, në vitin 2023, ambasadori i atëhershëm në Amerikë, Marko Gjuriç, nënshkroi kontratat për angazhimin e dy shtëpive lobuese. Rreth tre muaj më parë, këto kontrata u vazhduan. “Shtëpia lobuese KARV ka nisur sërish të punojë për Qeverinë e Serbisë që nga 17 korriku. Sipas një kontrate njëvjeçare, qeveria është e detyruar të paguajë 60’000 dollarë në muaj plus shpenzime shtesë. Për Ambasadën e Serbisë në SHBA është angazhuar grupi BGR për 50’000 dollarë në muaj për një periudhë njëvjeçare”.

Domethënë, qeveria serbe jep mini-

mum 110’000 dollarë në muaj për të lobuar në Uashington ose rreth 1,3 milion dollarë në vit.

Kosova lehtësisht do të mund të jepte dhjetëfishin. 13 milionë dollarë do të ishin një investim i duhur në Uashington për të mirën e Kosovës. Qeveria e Kosovës mburret se buxheti për vitin 2025 do të jetë 3,6 miliardë euro.

Për t’i ndarë, ta zëmë, 13 milionë për lobim, Kosova do të duhej të kishte politikanë udhëheqës që e kuptojnë se përkrahja nuk fitohet duke u thirrur në “miqtë tanë të përhershëm”, në “ndërrhyrjen e suksesshme të NATO-s”, në “të arriturat demokratike të Kosovës” etj., etj. Përkrahja fitohet jo duke u marrë me cikërrima - “kaq kemi kursyer” -, por duke gjetur mënyra për të depërtuar te vendim-marrësit në Uashington. Detyra e qeverisë nuk është të kursejë, por të harxhojë buxhetin në të mirë të shtetit.

Ndërsa një firmë konsulencash në kryeqytetin e SHBA çdo vit merr 600’000 dollarë nga Beogradi për ta përkrahur punën e Ambasadës së atjeshme të Serbisë, Ambasada e Kosovës në Uashington ka vetëm dy-tre diplomatë dhe ambasadori, për fat të keq, detyrohet të kryejë edhe një punë tjetër: atë të shoferit. Sepse Ambasada nuk ka as shofer.

Ndërkohë që qeveria serbe ka siguruar qasje të thellë në të dy partitë amerikane, kryeministri i Kosovës

KURSIMET FATALE, AMBASADA MË E RËNDËSISHME PA SHOFER DHE POTHUAJ PA DIPLOMATË

mban ligjërata mbi problemet e së majtës në botë, kurse ministrja e tij e Jashtme duket se ndihet më komode në takime me diasporën ose pjesëmarrje në ndeshje futbolli të ekipeve të diasporës. Në takimet me mërgatën shpesh nuk mungon as kryeministri. Në vitin 2017, Ministria e Jashtme i urdhëronte diplomatët të kthehen në Kosovë për të ngjitur posterë për PDK-në, tash disa ambasada - nën sloganin propagandistik se kryeministri apo ministrja e tij e Jashtme po zhvillojnë “takim me bashkatdhetarë”- lejojnë të bëhen pjesë e fushatës elektorale.

Shtëpia lobuese amerikane KARV, e cila punon për qeverinë serbe, drejtohet nga Andrew Frank, një ekspert për komunikim në kohë krizash. Frank ka punuar në administratën e presidentit Bill Clinton. Sipas NIN “grupi BGR, që punon për ambasadën (e Serbisë në Uashington), është një nga firmat kryesore të lobimit dhe relacioneve publike në Uashington, me lidhje të mira si me republikanët ashtu edhe me demokratët. Firma është e njohur për aftësinë e saj për të ndikuar në politikë dhe opinionin publik përmes lidhjeve të ngushta në Uashington. Edhe pse pozicionohet si e afërt me të dyja partitë amerikane, grupi BGR ka rrënjë të forta republikane, çka do të thotë se ka lidhje të mira me administratën e sapozgjedhur”.

Kjo nuk është e tëra sa i përket investimeve të shtetit serb në Uashington. NIN shkruan se ka pretendime

jozyrtare se këshilltar i pushtetit në Beograd është John Rendon, një konsulent i specializuar për operacione psikologjike (me fjalë të tjera: një ekspert i larë, i shpëlarë dhe i ndotur me të gjitha ujërat, aktiv në qarqet politike në Uashington nga vitet 1980-të dhe, sipas gazetarëve të famshëm amerikanë, i lidhur me shërbimin sekret CIA). Në burime të hapura në internet mund të gjenden shkrime nga qershori i vitit 2023 në të cilat thuhet se Rendon është duke e këshilluar qeverinë e Serbisë lidhur me dialogun me Kosovën dhe marrëdhëniet me Rusinë. NIN është i bindur se John Rendon është lidhur me pushtetin në Beograd përmes ambasadorit aktual Christopher Hill. Të dy njihen nga koha kur operonin në Irak: njëri si specialist për relacione publike, tjetri si diplomat amerikan.

Kur para disa ditësh biseduan përmes telefonit presidenti i zgjedhur amerikan Donald Trump dhe kryetari serb Aleksandar Vuçiq, të pranishëm ishin edhe Elon Musk dhe Christopher Ruddy. Kush është ky i fundit? Në janar 2010, gazeta britanike “Daily Telegraph” e renditi Ruddy si njërin nga “100 konservatorët më të fuqishëm” në SHBA dhe nënvizoi: “Chris Ruddy është një lojtar gjithnjë e më i fuqishëm edhe në mediat konservatore dhe përtej tyre.”

Ruddy është mik i ngushtë dhe i ngahershëm i Donald Trumpit, si dhe drejtor ekzekutiv i stacionit televiziv “Newsmax”, i cili ka nisur së fundmi

të transmetojë program për Serbinë në bashkëpunim me Telekomin serb. “Newsmax” mbështet republikanët. Deri këtu nuk u përmendën fare edhe disa kontakte të tjera të ngushta të regjimit në Serbi me këshilltarë dhe familjarë të presidentit të zgjedhur amerikan.

Është e vërtetë që presioni ndaj qeverisë së Kosovës në katër vitet e fundit nga Uashingtoni dhe Brukseli ka qenë i pabalancuar dhe shpeshherë i padrejtë. Por kjo situatë e pakëndshme nuk duhet të shërbejë si arsye nga qeveria për mosveprim në politikën e Jashtme. Fjalimet patetike të krerëve të Kosovës në Këshillin e Sigurimit të OKB-së nuk sjellin asgjë konkrete. Janë si lojëra tenisi ku publiku (eventualisht) i brohoret lojtarit të vet. Duhet zhvillim i mendimit strategjik, duhen plane konkrete, duhet kuptim më i gjerë i dridhjeve tektonike në politikën botërore.

Për të gjitha këto duhen profesionistë, duhen zyrtarë kompetentë. Duhet dhe shefa që kërkojnë llogari nga çdokush që ngarkohet me një përgjegjësi të caktuar. Duhet të jetë më aktive edhe presidentja e Kosovës, sepse, siç po shihet ashiqare, krerëve të shtetit po u mungon një koordinim i duhur dhe një strategji e përbashkët për politikën e Jashtme. Kjo mangësi nuk mund të mbulohet me vizita dosido dhe takime dosido në SHBA apo vende të tjera.

© Enver Robelli - KOHA

gjitha ato vendoset një prapashetë tek emri: P.sh në rumanisht fjala zi, që do të thotë ditë e pashqar, merr formën ziuza – dita, e shqar; në bullgarisht tzaritsa që do të thotë mbretëreshë e pashqar, merr trajtën tzarisata – mbretëresha, e shqar.

Shumë gjuhëtar konsiderojnë se një “substrakt” gjuhësor, ashtu siç shfaqet, si një gjuhë më e vjetër, njëherë e një kohë e folur në të tërë rajonin, para se të zhdukej ndikonte tek të gjitha gjuhët e mbijetuar në të njëjtën mënyrë. Disa e konsiderojnë Latin substraktin kryesor gjuhësor të Ballkanit, i cili në shekujt e fundit të Perandorisë Romake e deri tek koha e pushtimeve sllave ishte folur me siguri gjerësisht nëpër Ballkan.

Ka të tjerë që argumentojnë se udhëtimet, migracioni, endjet sezonale të çobanëve me bagëtitë që i kullonin nga një vend në tjetrin, përdorimi i dy-gjuhëve midis popujve të Ballkanit, i cili ka zgjatur për një periudhë shumë të gjatë (të paktën që nga koha e Perandorisë Romake deri në kohët e sotme) i solli të gjitha gjuhët më afër njëra tjetrës. Rumanishtja, veçanërisht

ajo arumune, midis shqiptarëve dhe rumunëve në veçanti, ishin përgjithmonë në lëvizje.

Alfabeti shqip

E vetmja kopje e mbijtur e librit të lutjeve të Buzukut, dalë në dritë në vitin 1555, me disa faqe që i mungojnë, gjendet në Bibliotekën e Vatikanit.

‘Ky është libri i parë në gjuhën tonë dhe ka qenë shumë e vështirë të bëhëj’ të thonë shqiptarët. Buzuku dhe disa shkrimtarë gegë, para shekullit të 19 – të, e përdorën alfabetin romak me germa të veçanta me disa bashkëtingëllore jo aq të njohura në tekstet e herëshme në toskërisht, te cilat gjenden nganjëherë të shkruara në alfabetin grek.

Por letërsia shqipe edhe nga veriu edhe nga jugu shpesh shkruhej dhe shtypej në të njëjtin alfabet, atë arab, pasi përdorej në gjuhën turke si gjuha sunduese e para shekullit të 20 – të, në Shqipëri.

Alfabeti modern i cili u themelua në

vitin 1908 në Kongresin e Manastirit, pas një debati të fortë, u pranua të ishte me 36 germa. Qeveria turke e kundërshtoi me forcë përpilimin e tij. Kjo mosmarrëveshje i kontribuoi shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë nga Turqia, më 28 Nëntor 1912. Autori Dalby boton edhe listën alfabetike të “shqipes së Manastirit” që nga germa “a” tek “zh” duke nënvizuar dyshkronjëshat e tij.

HARTA E ALFABETIT SHQIP

Dy grupet e mëdha dialektore Gegë dhe Toskë janë mjaft të ndryshme nga njëra tjetra. Ato janë aq të ndryshme sa disa i konsiderojnë si dy gjuhë të ndryshme konstaton, ndoshta jo krejt me të drejtë Profesor Dalby. Gëgnishtja, thotë ai, ka më shumë zanore së sa ajo toskërishte, pra jo vetëm shtatë që janë të regjistruara në alfabetin shqip, por edhe pesë hundore të cilat mund të ishin shkruar me gërmat â, ê, î, ô, ý.

Gëgnishtja veçanërisht, ajo e folur në jugun e saj, në Elbasan, ishte përcak-

tuar qartë si standart në fillimin e shekullit të 20 – të. Por që nga viti 1945 është toskërishtja ajo që i ka zënë vendin gëgnishtes. Gëgnishtja është gjuha e folur e 1.750.000 shqiptarëve në veri të Shqipërisë pa numëruar ata shqiptarë që jetojnë në Kosovë dhe viset shqiptare përrreth. Toskërishtja flitet në jug të Shqipërisë, në pjesët qendrore të Greqisë dhe në rajonet e banuara prej arbëreshëve të Italisë. Dialekti toskë i Sicilisë dhe i jugut të Italisë është i njohur si Arbëresh ndërsa ai i Greqisë si Arvanitika.

Po ashtu ka folës të toskërishtes në Bullgari, Ukrainë, afër Melitopolit. Bashkësi gëgnisht – folëse të quajtur Arbanasi gjenden afër Zarës në bregdetin dalmat. Shqiptarët në jug të Italisë dhe në Greqi janë aty prej shumë shekujsh por që numerikisht ndryshojnë sipas valëve migratore.

Në përpjekjet e tij për të ilustruar Gjuhën Shqipe autori jep edhe një vjershë të gjuhës shqipe e cila numëron mbrapsht që nga numri dymbëdhjetë për muajt e vitit deri tek dy lulet e vashës. Kjo këngë është

rregjistruar në shumë variante në fshatra të ndryshme, thotë autori.. Disa thonë: Muajt i dhjetë e kap pushkën, ndërsa disa të tjerë: “dy molla i ka vasha”.

Autori bazohet tek studimet e Max Lambert, Lehganddes Albanischen part 3 (Halle: Niemeyer, 1959) p.p. 219-25 Eric P. Hamp, ‘Albanian’ in Indo – European numerals ed. Jadranca Gvozdanovic (Berlin: Mouton De Grunter, 1992) pp. 835 – 927.

Ky studim i thellë shkencor ka rëndësi pasi hedh teza të reja në lidhje me shtratin e gjuhës tonë dhe të mardhënjeve të saj me ato ballkanike.

Një studiume me njohuri kaq të gjera shkencore për aq shumë gjuhë të botës ka sjellë në atë fjalor aq të madh teza shumë interesante. Studimi përbën një vlerë të jashtëzakonshme pasi gjendet në një fjalor shumë prestigjioz në gjuhën angleze. Fjalori gjendet në Bibliotekat Amerikane duke filluar nga Libraria e Kongresit dhe Biblioteka Publike e New Yorkut deri në Oxford e Cambridge.

LUTFI DERVISHI

PSE (NUK) MUND TË MBYLLET TIKTOK?

Kur makina shtypi njeriun e parë, kori i atyre që donin të ndalonin makinën nga qarkullimi nuk ishte i vogël.

Si mund të vdesë njeriu nga makina?! Skandal? Çfarë është kjo monster që vret njerëz. Me kuajt ishim rehat.

Makinat nuk u ndaluan, por u investua shumë në infrastrukture, në sinjakistikë, në rregullore, në masat e sigurisë. Makina vazhdon të marrë jetë njerezish edhe sot, por askujt nuk i shkon në mendje të nxjerrë makinën nga rruga.

Debati i hapur sot nga kryeministri për të mbyllur tik tok dhe snap chat per shkak se nxisin bulizmin, gjuhën e urrejtjes ka vlerë vetëm nëse nxirren mësim nga pësimet dhe nuk shkojmë në zgjidhje alla Adhamudh.

Sot teknologjia nuk është thjesht një mjet; është një pjesë integrale e jetës sonë. Nuk divorcohem dot nga jeta digjitale. TikTok, Snapchat dhe platformat e tjera sociale nuk janë burimi i problemit – ato janë mjete, ashtu si makina, që përdornim dhe që përdorim edhe sot. Problemi nuk qëndron tek TikTok dhe platformat e tjera, por tek mënyra si ne i përdorim dhe si i menaxhojmë efektet e tyre në shoqëri.

Nëse mbyllim Tiktok dhe snapchat, a jemi të sigurtë se në platforma të tjera nuk ka bullizëm, gjuhë urrejtje, veprime të paligjshme?!

Në vend që të mbyllim këto platforma, duhet të investojmë në “infrastrukturën” sociale.

Në anarkinë e botës digjitale që po jetojmë zgjidhja duhet kërkuar te edukimi dhe jo ndalimi.

Një përdorues i mirëinformuar fiton dhe nuk humbet nga rrjetet sociale. Në vend që t'i shmangemi teknologjisë, duhet të edukojmë fëmijët dhe të rinjtë se si ta përdorin në



dobi të tyre atë.

Kurrikulat shkollore duhet të kenë lëndë mbi etikën e përdorimit të mediave sociale dhe njohuri mbi privatësinë, bulizmin dixhital dhe ndikimin emocional që nesër mund të vijë jo vetëm nga përdoruesit njerëzit, por edhe nga botet dhe Inteligenca Artificiale.

Ashtu si sinjalistika rrugore rregulloi trafikun, ligjet duhet të rregullojnë përdorimin e teknologjisë.

Mund të vendosen kufizime për algoritmet që promovojnë përmbajtje të dëmshme ose të përcaktohen mekanizma më të fortë për raportimin e bulizmit dhe gjuhës së urrejtjes.

Mund të investohet më shumë për të

luftuar krimin kibernetik për t'ia ngulur në mendje “trimit” dhe “anonimit” se në rrjet “nuk është aq i padukshëm dhe i pakapshëm sa mendon”

Ashtu si fëmijët nuk lejohen të ngasin makinën pa një licencë, edhe qasja e tyre në teknologji mund dhe duhet të jetë e mbikëqyruar. Prindërit dhe mësuesit kanë një rol për të luajtur në mësimin e vetëkontrollit dhe përdorimit të vlefshëm dhe etik të teknologjisë.

Ashtu si makinat kanë evoluar me rripa sigurie, airbagë dhe sensorë që shmangin aksidentet, edhe platformat dixhitale mund të zhvillojnë teknologji që minimizojnë rreziqet.

Algoritmet duhet të programohen për të favorizuar përmbajtje pozitive, ndërsa përdoruesit duhet të kenë informacionin e duhur se si të dalin nga një mjedis toksik on line.

Në vend që të demonizojmë dhe të mbyllim një platformë, le të hapim debatin mbi efektet që ka teknologjia mënyrat më të mira për ta përdorur atë. Të mbyllim hapësirën virtuale apo të flasim për një mjedis dixhital të shëndetshëm?

Mbyllja nuk është zgjidhje!

Ashtu si nuk ndaluan makinat, nuk mund të ndalojmë rrjedhën e teknologjisë. Aq më tepër që me Inteligjencën Artificiale nuk jemi para një rrjedhe, por një dallge të madhe.

Çdo përpjekje për të mbyllur platformat dixhitale është një luftë kundër erërave të kohës. Nëse te mbyllja kërkojmë zgjidhjen kemi injoruar rrënjët e problemit.

Në fund të fundit, platforma si TikTok nuk janë “monstra” që duhet të eliminohe, por “makina të reja” që kërkojnë rregullore, edukim dhe përgjegjësi.

Në vend që të bëjmë luftë me teknologjinë, le të investojmë të mësojmë si të bashkëjetojmë me të.

Nëse duhet të shpallim luftë, para se të ç'armatosim duart, duhet të ç'armatosim mendjen, zemrën, dhe gjuhën. A e bëjmë dot këtë?

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Dotech
website 

Akoma nuk jeni
regjistruar
në Google?

NA KONTAKONI

Adresa e zyrave
30 Avenons Road
London E13 8HT



Vendoseni
biznesin tuaj
ne rrjetin e
bizneseve ne UK

020 7018 7929  Mob: 073 4066 5946  078 5997 7545

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545



**PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI
NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD,
LONDON, E13 8HT**

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ



**NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES**

VETON SURROI

KARAFILAT E CELESTE CAEIROS

Karafilat e saj në tyta u fotografuan e fotografitë qarkulluan botën, ndërsa jepej lajmi se kryengritja e ushtarakëve kishte rrëzuar diktaturën. U quajt "Revolucioni i karafilave", edhe sinonim se diktatura u rrëzua pa dalë plumb prej tytave – në to qenë karafilat

1.

Celeste Caiero vdiq një ditë para se të mbusheshin një mijë ditët nga fillimi i luftës pushtuese të Rusisë kundër Ukrainës.

Kishte mbushur 91 vjet dhe hyri aksidentalisht në histori.

U nis një ditë prilli në punë si zakonisht, për ta hapur derën dhe për t'i mbajtur palltot e mysafirëve e për t'ua treguar vendin në tavolina në restorantin "Sir" të Lisbonës. Pronari i restorantit u kujdes që të mos jetë një ditë si çdo tjetër. Ishte përvjetori i restorantit, që përgatitur një menu i veçantë për drekë e darkë, qenë rezervuar të gjitha tavolinat dhe në çdonjërin prej tyre qenë vendosur karafilat kuq e bardhë. Përderisa bëhej gati për këtë ditë të veçantë, Celeste vërejti fytyrën e brengosur të pronarit, ndërsa dëgjonte lajmet në një radiostacion klandestin që emetohej përkundër censurës së diktaturës në pushtet.

-Sot po e mbyllim restorantin, ka filluar kryengritja, i tha pronari. Dhe i tha që t'i merrte lulet se këtu do të thaheshin.

Celeste Caiero doli në rrugë dhe jo shumë hapa më tej pa kolonën e ushtarëve që ishin ngritur në kryengritje kundër pushtetit diktatorial. Shumica, në fakt ishin ngritur ndaj një pushteti që po i dërgonte të vdiste në luftërat koloniale kundër popujve të Angolës, Mozambikut e vendeve të tjera – fëmijët e varfër të fshatrave të Portugalisë duke vdekur në luftë kundër fëmijëve të varfër të fshatrave të Angolës e kolonive të tjera.

Njëri prej këtyre ushtarëve i kërkoi Celestes mos kishte cigare. Ajo tha që nuk pinte duhan dhe meqë nuk kishte gjë tjetër për t'i dhënë, ia dha një karafil. Ai e vuri në tytën e pushkës. Celeste i shpërndau të gjithë karafilat e saj, njëri prej tyre përfundoi në tytën e automatikut të një autoblinde. Karafilat e saj në tyta u fotografuan e fotografitë qarkulluan botën, ndërsa jepej lajmi se kryengritja e ushtarakëve kishte rrëzuar diktaturën. U quajt "Revolucioni i karafilave", edhe sinonim se diktatura u rrëzua pa dalë plumb prej tytave - në to qenë karafilat.



2.

Celeste Caiero i dha karafilat e saj më 25 prill të vitit 1974 dhe e përfundoi çerekun e fundit të shekullit bashkë me mua. Figurativisht.

Portugalia pati zgjedhjet e veta të para të lira parlamentare dhe së shpejti u anëtarësua në Bashkimin Evropian (Komunitetin e atëhershëm ekonomik).

Më 1989, ra Muri i Berlinit dhe shtetet e Evropës Qendrore dhe Lindore u liruan prej komunizmit.

Më 1999 NATO-ja ndërhyri për parandalimin e gjenocidit në Kosovë dhe e çliroi atë.

Në mesin e forcave të NATO-s ishte edhe ajo e Portugalisë. Ushtria të cilën Celeste Caiero e kishte bekuar me karafila ishte njëra prej ushtrive që sollli paqe në Kosovë.

Ky ishte çerekshekulli i një vale të madhe demokratike që kishte filluar edhe më herët, me dekolonizimin dhe formimin e qeverive autoktone në vende të Afrikës e të Azisë. Në atë çerekshekull, edhe shumë popuj të vendeve të Amerikës Latine kalonin

prej diktaturave ushtarake në demokraci.

3.

Celeste Caiero vdiq në vitin e tetëmbëdhjetë me radhë që, sipas Freedom House, shënon regresion të demokracisë. Pra, vdiq në shekullin XXI që për dallim të atij që u shënuar edhe me karafilat e saj, nuk është më shekull i lirisë, por i rirreshtimeve gjeopolitike. Është, në këtë çerek-shekull të tij të parë, shekulli i gjeopolitikës.

Dhe është ende i pakapshëm për t'u definuar. Kështu e kuptoj nga shumë njerëz që njoh nga e tërë bota e që janë mbledhur në Konferencën e Sigurisë në Beograd për ta përcaktuar ecjen e kësaj bote. Tema e parë, natyrisht, është se si do të ecë kjo botë pas fitores së D. Trumpit si president, me një lloj parandjenje apo frike të integruar, sikur bota ka qenë duke shkuar mirë, porse ja, do të dalë presidenti i ri amerikan dhe do ta prishë rendin botëror.

E rendi botëror tashmë është prishur. Një diplomat britanik Rob Dixon, përmend se ky rend nuk u prish në shkurt të vitit 2022 kur Rusia hyri në Ukrainë me fuqi të plotë ushtarake, por më 2008 kur hyri në Gjeorgji. Ukrainasit me vite të tëra përsërisin se Rusia hyri në Ukrainë më 2014 në Donbas e në Krime.

Dhe, ja më 2024, në të mbushur një mijë ditët e luftës më të madhe pushtuese evropiane pas fundit të Luftës Botërore, me një llogari të një milion të vlarëve në të, Celeste Caiero nuk do të jetojë më për të parë se si është vazhdimi.

4.

Si do të vazhdojë ky shekull? Federica Mogherini, ish-shefja e politikës së jashtme të BE-së u pyet se a do të ishte e gatshme BE-ja të merrte me shekullin e gjeopolitikës, prej politikës së presidentit Trump, fundit të luftës në Ukrainë e deri te antagoinizmi me Kinën dhe ajo u përgjigj me një fjali të gjatë që filloi me "BE-ja do të mund të ishte e gatshme...". Pra nuk është e gatshme.

Ukrinasit që kanë kaluar prej një konference në tjetrën përgjatë këtyre një mijë ditëve thonë që ardhmëria është me luftë edhe tre, pesë, dhjetë vjet dhe se mund ta ndalin vetëm kur Ukraina hyn në NATO. Që për Rusinë dhe NATO-n do të ishte atëherë luftë e ndërsjellë.

Yezid Sayigh, një intelektual i spikatur palestinez, dhe i angazhuar për kauzën palestineze tha se sot nuk ekziston më Lëvizja Kombëtare Palestineze që ka ekzistuar deri më 7 tetor të vitit 2023. "Unë nuk do ta shoh brenda jetës sime shtetin palestinez".

Antonio Gramsci, i vdekur para gati njëqind vjetësh u bë përnjëherë i gjallë në këtë konferencë me një citat që i shërben shpjegimit të këtij shekulli:

"Kriza qëndron saktësisht në faktin se e vjetra po vdes dhe e reja nuk po mund të lindë; në këtë interregnum, një larushi simptomash morbide mund të shfaqen.

ALEXANDER RHOTERT

SERBIA PO ARMATOSËT. SA KA RREZIK PËR LUFTË NË BALLKAN?

Serbia u armatos shumë vitet e fundit, tani është shteti ushtarakisht më i fortë në Ballkanin Perëndimor. Shtetet fqinje janë të shqetësuara për synimet ekspansioniste të Beogradit.

A po planifikon Serbia të destabilizojë apo edhe të sulmojë ushtarakisht shtetet e saj fqinje Kosovën dhe Bosnje-Hercegovinën? Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, dhe homologu i saj boshnjak Denis Beciroviq paralajmëruan së fundmi për këtë skenar. Osmani tha në një intervistë televizive në shtator se kishte shpresë që Ballkani Perëndimor të anëtarësohet në BE dhe NATO, “por parakusht për këtë është ta trajtojmë Serbinë ashtu siç është: një shtet satelit i Rusisë, i cili thëllon bashkëpunimin ushtarak, ekonomik dhe politik me Rusinë”. Paralajmërimi i Beciroviqit për dëshirat territoriale të Serbisë para Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork ishte edhe më i fortë: “Nga foltorja e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dëshiroj të paralajmëroj publikun botëror se udhëheqja e Republikës së Serbisë kërcënon edhe një herë të cenojë sovranitetin dhe integritetin territorial të Bosnjë-Hercegovinës”.

Beogradi po armatoset

Në fakt Beogradi ka vite që po armatos masivisht ushtarakisht e vendit me sisteme moderne armësh. Beogradi ka blerë avionë luftarakë francezë dhe helikopterë sulmues rusë, të cilët presidenti serb Aleksandar Vuçiç i quajti “tanke fluturuese”. Përveç kësaj menjëherë pasi Rusia sulmoi Ukrainën Pekini dërgoi në Serbi sisteme kineze kundërajrore. Po ashtu ka njoftime që Serbia ka blerë nga Irani mijëra dronë, të atij tipi që Rusia i përdor çdo ditë kundër qyteteve ukrainase.

Revista “The Economist” shkruante në vitin 2021 se “blerjet e armëve”



nga Beogradi po i frikësojnë vendet fqinje. Kurse Instituti i njohur suedez për Kërkime për Konfliktet SIPRI deklaroi në vitin 2022 se buxheti i Beogradit për mbrojtjen është 1.3 miliardë euro, pra dhjetë herë më i madh se ai i Kosovës.

Epërsia ushtarake e Serbisë ilustron edhe nga inventari i saj i tankeve. Me rreth 250 tanke, Serbia ka më shumë tanke se të gjitha republikat e tjera të ish-Jugosllavisë së bashku – për krahasim: ushtria gjermane, Bundeswehr, ka 295 tanke. Kroacia renditet në vendin e dytë me 75, Bosnja në vendin e tretë me 45, e ndjekur nga Maqedonia e Veriut me 31. Kurse as MaMali i Zili i Zi dhe as Kosova nuk kanë tanke.

Kjo është ndoshta një nga arsytet pse forcat e armatosura të Kosovës u pajisën vitin e kaluar me drone turke Bayraktar dhe këtë vit me 250 raketa amerikane antitank Javelin.

Projekti për një botë serbe

Shtrohet pyetja pse Beogradi ka

grumbulluar një arsenal të madh armësh ndër vite pa pasur kërcënim nga fqinjët e tij. A po bën presidenti Vuçiç plane për të sulmuar vendet fqinje, siç paralajmëroi presidentja e Kosovës?

Të paktën kështu sugjerojnë deklaratat, kërcënimet dhe veprimet e udhëheqjes serbe në Beograd. Ajo propagandon projektin e “Botës Serbe”, një version pasardhës disi i zvogëluar i “Serbisë së Madhe” të ish-presidentit serb Slobodan Millosheviç, duke ndeshur kështu në rezonancë me serbët në vendet fqinje, në Kosovë dhe Bosnjë.

Kuvendi mbarëserb

Në fillim të qershorit 2024 Vuçiçi drejtoi një “kuvend mbarëserb” në Beograd me përfaqësues të serbëve nga të gjitha zonat e ish-Jugosllavisë, një takim strategjik që formuloi në thelb planin për zbatimin e “Botës Serbe”. Në “Deklaratën mbarëserbe” Kosova përmendet si pjesë e Serbisë dhe Republika Srpska, pjesa e dominuar nga serbët e Bosnjës dhe Hercegovinës, si “interes kombëtar i Serbisë”.

Një zëdhënës i Ministrisë së Jashtme në Berlin e dënoi këtë deklaratë në mënyrë jashtëzakonisht të ashpër. Qeveria gjermane e konsideron Deklaratën mbarë-serbe “shumë shqetësuese dhe të dëmshme për Bosnjën dhe Hercegovinën, për Serbinë dhe për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor”.

Beciroviçi e komentoi takimin e Beogradit në fjalimim e tij në Kombet e Bashkuara si vijon: “Deklarata shkatërruese e të ashtuquajturit Kuvend mbarë-serb, e miratuar më 8 qershor të këtij viti në Beograd, nuk është vetëm një veprim deklarativ, por një dokument i rrezikshëm për një shtet të madh”.

Luftë në Ballkan?

Asnjë nga vendet fqinje që duket se janë në shënjestër të dëshirave territoriale të Beogradit nuk kanë forca të armatosura “të gatshme për luftë”. Pa mbrojtjen e dy misionëve paqeruajtës perëndimorë të NATO-s në Kosovë (KFOR) dhe BE-së në Bosnje (EUFOR/Althea), ata do të ishin pre

e lehtë për ekspansionizmin agresiv të Beogradit.

Vitet e fundit bëri disa herë bujë dhe shkatoi trazira dislokimi i trupave serbe në kufirin me Kosovën dhe sulmi i një njësie paraushtarake serbe ndaj forcave të sigurisë së Kosovës. Kjo për shkakun se sulme të tilla të njësisë paraushtarake serbe u kishin paraparirë luftës në Kroaci në vitin 1991 dhe asaj në Bosnje një vit më vonë.

Incidentet e fundit ushtarake mund të kenë qenë balona prove të Beogradit. Por meqenëse reagimet e SHBA-së dhe NATO-s ishin shumë të shpejta dhe të mprehta, Beogradi u tërhoq. Në gusht 2024 Uashingtoni ndërhyri sërish, këtë herë me drejtorin e CIA-s, William Burns, i cili shkoi në Bosnje dhe Hercegovinë posaçërisht për të ndaluar veprimet separatiste të liderit serb të Bosnjës, Millorad Dodik. Ai ka ndërmarrë vazhdimisht hapa për të shpallur pavarësinë e Republika Srpska dhe ka pajisur mijëra paraushtarake. Politikanët në kryeqytetin Sarajevë po përgatiten për mundësinë që Republika Srpska mund të vazhdojë përpjekjet për shpëtimin. Në rast se do të lindë një konflikt i armatosur dhe serbët e Bosnjës do të vihen nën presion ushtarak, ka shumë të ngjarë që Beogradi të dërgojë tanket e tij në Bosnje për t'i shpëtuar ata.

Një luftë e re në Ballkan nuk mund të përjashtohet. Dhe tani që Donald Trump do të marrë sërish pushtetin në Uashington, është plotësisht e paqartë se si do të sillt superfuqia SHBA në një rast të tillë. Një kandidat premtues për postin e ministrit të Jashtëm është ish-ambasadori amerikan në Gjermani, Richard Grenell. Së bashku me dhëndrin e Trumpit, Jared Kushner, ai ka interesa të forta biznesi në Serbi.

(Alexander Rhotert është politolog, i specializuar në ish-Jugosllavi)

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



AURENC BEBJA

“The Christian Science Monitor” ka botuar, të mërkurën e 28 majit 1913, intervistën ekskluzive asokohe me Isa Boletinin dhe Luigj Gurakuqin në hotelin Cecil, në Londër, të cilën, Aurenc Bebjë, nëpërmjet Blogut “Dars (Klos), Mat – Albania”, e ka sjellë për publikun shqiptar :

Isa Boletini thotë se shqiptarët do t'i rezistojnë sundimit të Serbisë

Londër — Isa Boletini, një nga liderët më të mëdhenj të Shqipërisë, një njeri që praktikisht ka rreth 10.000 ndjekës të devotshëm në dispozicion, është padyshim një njeri i aksionit dhe jo i fjalëve. Nëse në fytyrën e një burri është shkruar ndonjëherë përcaktimi i qëllimit, ai është stampuar në tiparet e habitshme të Isa Boletinit.

Ky shef i njohur shqiptar, i shoqëruar nga Luigj Gurakuqi, gjithashtu një anëtar i qeverisë shqiptare, i cili vepron si përkthyes i tij, duke qenë në gjendje të flasë frëngjisht, ishte shumë i interesuar për politikën e The Christian Science Monitor, siç iu shpjegua së fundmi, gjatë qëndrimit të tij në Londër në Hotel Cecil. Në ankh për të bërë çdo përpjekje të mundshme për të nxitur fuqitë evropiane që t'i mundësonin Shqipërisë lulëzimin e saj, Isa Boletini ishte shumë i gëzuar për mundësinë për të diskutuar mbi situatën aktuale të Ballkanit me një përfaqësues të një gazete me një tirazh kaq të gjerë.

Isa Boletini është një përfaqësues i jashtëzakonshëm i kësaj race të fuqishme shqiptare. I mësurar me jetën e egër në natyrë të një udhëheqësi burrash, shtëpitë e të cilëve janë në kodra, Isa Boletini, i veshur me kostumin e tij kombëtar, duket krejtësisht si në shtëpinë e tij në mjedisin e hotelit Cecil. Kjo është vizita e parë e shefit në Angli dhe është e qartë nga mënyra se si ai zbret shkallët, duke bërë tre ose katër hapa njëkohësisht, se vizita e tij aktuale, sado interesante dhe e rëndësishme, ka më shumë shijen e izolimit të detyruar sesa të kënaqësisë së patrazuar.

Ai dëshiron të çlirojë tokën e tij

Pozicionin e tij si shef ia detyron përpjekjeve të të parëve të tij, sepse e mira e familjes, të cilës i përket Isa Boletini, nuk është shumë e vjetër. Prej vitësh ai i është përkushtuar shërbimit të vendit të tij, qëllimi i tij i vetëm ka qenë çlirimi i popullit nga zgjedha e Turqisë, siç do të jetë çlirimi i tyre nga skllavëria e sundimit serb. Ai ka një ndikim të madh në vendin e tij, ai është i respektuar dhe i besuar nga ndjekësit e tij të shumtë, të cilët kanë besimin maksimal në opinionet dhe udhëheqjen e tij.

Luigj Gurakuqi është arsimuar në Itali dhe ka mësuar edhe frëngjisht, kështu që mundi të fliste në emër të Isa Boletinit, i cili nuk mund të fliste në asnjë gjuhë përveç asaj që flitej nga shqiptarët.

— Qeveria e përkohshme u krijua, shpjegoi ai, në fund të nëntorit të kaluar në Vlorë, por ne nuk kemi mundur të largohemi nga vendi para luftës dhe më vonë bllokadës. Megjithatë, pak më shumë se një muaj më parë, rrugës për në Londër, ne vizituam Romën, Vjenën dhe Parisin. Ndjenja në Londër në lidhje me vendin



tim, shpjegoi ai, është përmirësuar shumë. Opinioni publik në fillim ishte më i favorshëm për fuqitë ballkanike sesa për ne; tani, megjithatë, ata e shohin idenë se Shqipëria duhet të jetë e pavarur me shumë më tepër favor se më parë. Me këtë dua të them se përfaqësuesit e shtypit dhe anëtarët e Dhomës së Komunave (House of Commons) janë më të prirur të mbështesin kërkesën tonë për pavarësi sesa ishte rasti më parë. Ata shohin, jam i bindur, drejtësinë e kërkesës dhe e vlerësoj shumë simpatinë që kam takuar gjatë vizitës sime këtu.

Vendimi nuk është i drejtë

Në përgjigje të një pyetjeje për situatën aktuale në Shqipëri, Luigj Gurakuqi shpjegoi se kur ata u larguan gjithçka ishte e qetë. Sigurisht, tha ai, çështja e Shkodrës dhe disa nga kufijtë e Shqipërisë janë zgjidhur.

— Sipas marrëveshjes aktuale një pjesë e konsiderueshme e territorit shqiptar do ti jepet Serbisë ?

— Po, me të vërtetë, dhe është pikërisht ajo pyetje që ne ngritëm në Romë me synimin për të arritur një marrëveshje më të mirë. Vendimi i fuqive është më i pafavorshmi për Shqipërinë, pasi nënkupton humbjen e gati gjysmës së vendit dhe 1.000.000 banorëve. Ju e dini shumë mirë, vazhdoi ai, kur çështja maqedonase u diskutua, u vendos që i gjithë territori të cilit i referohem dhe që i është dhënë Serbisë dhe jo Malit të Zi ishte shqiptar. Ne diskutuam të njëjtën pikë në Vjenë. Por, kur kishim mbërritur në Paris, situata kishte ndryshuar përsëri, sepse Shkodra kishte rënë dhe kishte ndodhur ngjarja e Esad Pashës. Por tani, çështja e Shkodrës është zgjidhur në favor të Shqipërisë, domethënë që ajo të mos shkojë në Mal të Zi, por të lihet në kujdesin e Fuqive për momentin, ndërsa incidenti i Esad Pashës është mbyllur, pasi ka shprehur dëshirën për të mbetur ushtar shqiptar dhe asgjë më shumë.

— Mendoni se Esad Pasha kishte ndërmend seriozisht të shpallej Princ i Shqipërisë ?

— Po, sigurisht që mendoj se e ka bërë, por vetëm dje morën një kablogram që thoshte se ai donte thjesht të shërbente në ushtri dhe të ndihmonte Shqipërinë në atë mënyrë.

— E konsideroni Esad Pashën një njeri të përshtatshëm për të qeverisur Shqipërinë ?

— Në fakt, historia e kaluar e Esad Pashës nuk e rekomandon atë për këtë post. Ai sigurisht u ngrit lart në vlerësimin e njerëzve nga mënyra madhështore që kreu mbrojtjen e Shkodrës, por tani me dorëzimin e qytetit popullariteti i tij është zvogëluar deri në pikën e zhdukjes. Esad Pasha sigurisht që i përket një familjeje të mirë të Tiranës, afër Durrësit, por nuk mund të konsiderohet më si kreu i mundshëm i shtetit të Shqipërisë.

Ndihet ambicia greke

Duke iu referuar sërish çështjes së kufijve, biseda iu drejtua ambicies së Greqisë dhe z. Gurakuqi, fare natyrisht, nuk mund të insistonte fort rëndësinë e kësaj pyetjeje për Shqipërinë. Ai shpjegoi se për të kuptuar siç duhet pyetjen duhet kuptuar se në Shqipëri ekzistojnë tri forma të fesë, myslimane, ortodokse dhe katolike.

— Tani, vazhdoi ai, grekët e keqkuptojnë plotësisht situatën saqë thonë se të gjithë shqiptarët që nuk janë myslimanë janë ortodoksë, prandaj janë grekë, me rezultat që kufiri verior i Greqisë duhet të shtrihet deri në Tepelenë. Ky argument, shpjegoi z. Gurakuqi, me theksin më të madh, është sa mashtrues aq edhe i gabuar. Do t'ju them diçka interesante në lidhje me metodat e përdorura nga grekët në përpjekje për të provuar se një pjesë e madhe e Shqipërisë duhet të jetë nën flamurin grek. Pak kohë më parë, edhe unë kisha një informacion absolutisht të sigurt për këtë temë, grekët i detyruan shqiptarët në rrethet e Paramithisë, Filatit, Margaritit, Gjirokastrës, Delvinës dhe Tepelenës, të bënin një mbledhje në të cilën u detyruan të nënshkruanin një telegram duke kërkuar që ato duhet të aneksohen nga Greqia. Siç e thashë, kam një informacion të caktuar për këtë pikë dhe jam i gatshëm t'ju njoftoj rrethanat në mënyrë që t'i jepni publikut mundësinë të mësojë faktet e vërteta të çështjes, në mënyrë që pushtetet të insistojnë që drejtësia të vihet në vendin tim.

Njerëzit nuk do të nënshtroheshin

— Më tej, ju ndoshta e dini mirë se në 1879 ministri britanik në Athinë dërgoi një raport në Londër në të cilin tregoi qartë se shumica e madhe e të krishterëve, si dhe myslimanëve, pikërisht

në ato rrethe që tani kërkon Greqia, ishin me origjinë dhe kombësi shqiptare. Nuk mundet, shtoi ai, të ndaleni shumë në këtë pikë, as t'i jepni shumë publicitet, sepse është një çështje që më intereson jetikisht mua dhe vendin tim, dhe sigurisht është e drejtë që rrethet që Greqia tani dëshiron të aneksojë, por popullsia e së cilës është pothuajse tërësisht shqiptare, nuk duhet t'i dorëzohet një vendi të huaj, qeverisë së të cilës nuk do t'i nënshtroheshin nëse nuk detyroheshin me forcë superiore.

— Çfarë do të thotë, sipas jush, Italia në rast se kërkesa e bërë nga Greqia do të pranohet ?

— Është e qartë, mendoj unë, se ashtu si Austria mbështeti kërkesat shqiptare në lidhje me kufirin verior, ashtu edhe në lidhje me kufirin jugor, Italia është e përgatitur të vazhdojë të luftojë gjatë për këtë çështje. E shihni, Italia është shumë e zgjuar për faktin se nëse Greqia merr territorin shqiptar përballë kanalit të Korfuzit, Italia do të përballet me një rrezik shtesë; meqenëse Greqia mund të krijonte lehtësisht një bazë të fortë detare atje, të cilën Franca ndoshta do ta përdorte një ditë, nëse do ta gjente veten ndonjëherë në luftë me Italinë. Më lejoni të them edhe një herë se ne shqiptarët tashmë kemi sakrifikuar shumë në veri dhe sigurisht që është e paarsyeshme të këmbëngulim që duhet të sakrifikojmë kaq shumë edhe në jug, dhe besoj se ky apel për drejtësi i bërë përmes kolonave të gazetës suaj nuk do të bjerë në vesh të shurdhër.

Shqipëria të bëhet e pavarur

— Cila mendoni se do të jetë e ardhmja e Shqipërisë ? A do të jetë një principatë apo një shtet i pavarur ?

— Në këtë pikë absolutisht asgjë nuk është vendosur. Siç e dini, ju e dini, megjithatë, Rusia është në ankh që Shqipëria të jetë një shtet i pavarur nën sundimin e Turqisë.

Nuk besoj se ka dyshim se Shqipëria do të jetë e pavarur, por nuk mendoj se do të jetë nën sundimin e Sulltanit të Turqisë, sepse shqiptarët nuk do t'i nënshtrohen kësaj më shumë sesa dëshirojnë Fuqitë e Mëdha. Ju pyesni se kush do të jetë kreu i vendit, por gjithçka që mund të them është se Mbreti, apo Princi ynë, nuk duhet të jetë as mysliman, as anëtar i kishave ortodokse apo katolike.

— Është e qartë atëherë, u përgjigj përfaqësuesi i Monitor, se sundimtari i ardhshëm i Shqipërisë duhet të jetë një protestant.

— Fakti është, vazhdoi z. Gurakuqi, ne nuk dëshirojmë të kemi ndonjë vështirësi fetare, dhe meqenëse në vend kemi myslimanë, katolikë romakë dhe anëtarë të kishës ortodokse greke, është e qartë se është më mirë që sundimtari ynë të mos jetë as një dhe as tjetri.

Më pas biseda u kthye te Xhavit Pasha,

i cili komandonte një brigadë nën Ali Riza Pashën.

— Kërkoj mendimin tuaj për këtë oficer, çfarë do të thoni ?

— Unë do të thosha, u përgjigj z. Gurakuqi, se Xhavit Pasha është “la bete feroce” për shqiptarët. Ai ishte, ju kujtohet, i dërguar nga Turqia për të zhdukur shqiptarët dhe mizoritë e kryera gjatë asaj periudhe janë çështje historie. Ai është tani në Berat, por trupat nën komandën e tij janë pakësuar në një grusht të vogël dhe nuk janë në gjendje të bëjnë asgjë më tej. Është e vërtetë që zyrtarisht Turqia ka pushuar së luftuari. Qeveria mund të mos lëshojë asnjë udhëzim që ai të sulmojë popullin tonë, por Xhavit Pasha si individ pa dyshim do të vazhdonte me kënaqësi taktikat e tij të ngjajës, nëse do t'i jepej mundësia.

Mbreti Nikita ka ndryshuar

— Dëshironi që unë të them diçka për mbretin Nikita? por s'kam shumë për t'ju thënë. Ai më parë, siç e dini, ishte miqësor me Shqipërinë dhe kur xhon-turqit sulmuar vendin tonë, mbreti Nikita na premtoi mbështetjen e tij, vërtet Isa Boletini ishte në Mal të Zi për tetë muaj gjatë asaj periudhe, por aktualisht mbreti Nikita nuk është më miku ynë. Në fakt, ai na braktisi kur ishim sulmuar nga armiqtë tanë dhe kishim nevojë më shumë për ndihmë, pastaj kur mbreti Nikita pa dobësinë tonë, ai pushoi vendin jo me qëllimin për të na çliruar, por me qëllimin për të na penguar dhe shtypur.

Si përfundim, më lejoni të them edhe një herë se ne kemi luftuar për vendin tonë dhe dëshiroj të shpreh përsëri shpresën e sinqertë që Evropa do të shohë që ne trajtohem me barazi dhe do të na japë drejtësinë që meritojmë, sepse me siguri do të jetë një padrejtësi e madhe nëse Shqipëria humbet një nga krahinat e saj më të mira.

Isa Boletini, duke parë se përfaqësuesi i Monitorit ishte gati të largohej, shpjegoi se ai do të kthehej në vendin e tij dhe do të vazhdonte të nxiste popullin të rebelohej kundër zgjedhës së Serbisë, pasi ata ishin rebeluar kundër shtypjes së Turqisë.

— Unë, tha ai, me gjithë dinjitetin dhe seriozitetin e një njeriu, jam i vendosur t'i kushtoj pjesën tjetër të jetës sime në shërbim të vendit tim dhe nuk kam synim tjetër përveç të shoh popullin tonë të çliruar nga indinjata e kontrollit të huaj. A mund ta imagjinoni, tha ai në përfundim, se shqiptarët do t'i nënshtrohen me qetësi zgjedhës së një kombi sllav, kur nuk mundën të duronin sundimin e Turqisë, megjithëse shumica e tyre janë myslimanë.

Isa Boletini është nga Kosova, për të cilën tha se fillimisht ishte pushtuar nga Serbia, gjë që shpjegon, sipas tij, shtimin e rrokjes “atz” në mbiemrin e tij nga serbët, për t'u dukur se është i kombësisë serbe.

Akoma nuk keni një website ?

The Albanian

Dotech
website 

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

**Suksesi fillon
nga nje website profesionale**



Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT



Tel: 020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946

Mob: 078 5997 7545